

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

(Raporti i hartuar ne baze te shtojca II dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015, per VNM)

"RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRES HISTORIKE NE VLORE, ZONA A"

Pergatitur nga:

"GJEOKONSULT & CO" SHPK &

"ARCHISPACE" SHPK

Tirane 2019

PERMBAJTJA

Hyrje

- I. Informacion për qëllimin e vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe metodikën e zbatuar*
- II. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti*
- III. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.*
- IV. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.*
- V. Përshkrim i shkarkimeve të mundshme në mjedis.*
- VI. Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative.*
- VII. Shtrirja hapësinore e ndikimit negativ në mjedisin e zonës.*
- VIII. Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të tij në gjendjen e mëparshme.*
- IX. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis (konkluzione dhe rekomandime).*
- X. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar.*
- XI. Konkuluzione*

Hyrje

Ky studim mbi realizueshmërinë e projektit është i bazuar në Termat e Referencës. Grupi i Ekspertëve ka punuar së bashku në mënyrë që të përmbledhë në këtë studim çështjet dhe pikat kryesore.

Qëllimi kryesor i projektit është: Restaurimi i monumenteve të kulturës dhe rikualifikimi urban izonës së studimit, në mënyrë që nëpërmjet restaurimit, konservimit dhe rehabilitimit të vendbanimeve tradicionale dhe i zonave të trashëgimisë kulturore të rritet turizmi dhe si rrjedhojë zhvillimi ekonomik i zonës.

Ky Vlerësim Paraprak i Ndikimit në Mjedis është i përgatitur për projektin **“Rikualifikimi Urban i Qendres Historike ne Vlore, Zona A”**, është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar për këtë projekt. Raporti është përgatitur për fazën e dytë *“Zona A para Bashkise Vlorë”* e cila nëpërmjet këtij projekti synon rivlerësimin e vlerave arkitektonike dhe historike të zonës, subjekt i projektit; rikthimin e vëmendjes tregtare me qëllim rritjen ekonomike të zonës dhe orientimi i turizmit në qytet jo vetëm drejt atij natyror por edhe turizmit kulturor, ku turistëve ti ofrohen site arkeologjike (Kalaja e Kaninës, qyteti antik i Orikut, kalaja e Vlorës) por edhe një bërthamë e qytetit të ndërtuar në fundin e mesjetës.

Qëllimi kryesor i projektit është *“Restaurimi i monumenteve të kulturës dhe rikualifikimi urban i zonës së studimit, në mënyrë që nëpërmjet restaurimit, konservimit dhe rehabilitimit të vendbanimeve tradicionale dhe zonave të trashëgimisë kulturore të rritet turizmi dhe si rrjedhojë zhvillimi ekonomik i zonës”*.

Zona për të cilën është hartuar projekti është zona ku qyteti i Vlorës ruan ende gjurmë të ndërtimeve të fundshekullit të 19-të dhe fillim shekullit të 20-të. Pothuaj e gjithë zona përfshihet brenda kufijve të zonës arkeologjike të qytetit, "A". Ky segment që prej vitit 1980, me V.K.M. Nr. 249, dt. 01/07/1980 *“Për vënien në mbrojtje shtetërore të lagjeve dhe ansambleve me vlera arkitektoniko-historike në qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë”* gëzon statusin e monumentit të kulturës të kategorisë së parë.


Në zonë kanë banuar dhe punuar patriotë dhe luftëtarë të shquar të çlirimit kombëtar, të luftës së Vlorës si: Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Isa Boletini, etj.

Emertimi i Objektivit: **“Rikualifikimi Urban i Qendres Historike ne Vlore, Zona A”**. Bashkia Vlore.


Vendndodhja: Nderhyrjet kryesore të propozuara do të jepen :

-  *Rikualifikimi i shesheve;*
-  *Rikonstruksioni i rrugës “Perlat Rexhepi” dhe trotuareve;*
-  *Rikonstruksioni i godinave; AO36 / AN24 / AN03 / BN 46 / BN 44*
-  *Rikualifikimi i dy shesheve publike (sheshi i kullës së sahatit dhe sheshi “4 heronjtë”) etj, **Bashkia Vlore.***

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS “RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRES HISTORIKE NE VLORE, ZONA A”.



RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS “RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRES HISTORIKE NE VLORE, ZONA A”.



Zona A e detajuar



Nr.	X	Y
Pika 1	4372140.685	4483230.409
Pika 2	4372123.245	4483297.824
Pika 3	4372418.153	4483371.501
Pika 4	4372395.048	4483433.378
Pika 5	4372392.914	4483492.217
Pika 6	4372342.175	4483463.385
Pika 7	4372273.317	4483318.525

Kordinatat sipas Gaus Kruger







Fotot e zones ku parashikohet te nderhyet per permiresimin e situates

I. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Raporti paraprake i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar mbi bazën e legjislacionit mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin disa procese:

- a) Procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) Procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Ligji mjedisor kryesor është Ligji Nr. 10431, datë 9 Qershor 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ky Ligj përcakton politikën kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin dhe vlerësimin strategjik mjedisor, kërkesat për dhënien e lejeve veprimtarive që ndikojnë mbi mjedisin, parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit, normat dhe standartet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, detyrat e organeve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, rolin e publikut dhe sanksionet e përcaktuara në rast të shkeljes të ligjit. Ligji përcakton objektivat e meposhtme të mbrojtjes së mjedisit:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdolloji;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrjen e publikut;
- Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dhe
- Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Ligji Nr.10440 datë 7/07/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të projekteve ose veprimtarive mbi mjedisin. Ligji përcakton hapat e nevojshme për zbatimin e procedurave të VNM: dorëzimin e kërkesës, shqyrtimin paraprak, kriteret e përzgjedhjes dhe klasifikimit, seancat dëgjimore dhe konsultimet publike, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organeve të tjera. Ligji përcakton gjithashtu listën e veprimtarive që duhet të jenë objekt i procesit të Thelluar dhe atij Paraprake të VNM.

Ligji i lart-përmendur nënvizon se qëllimi i Vlerësimit Mjedisor është të sigurojë: *Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendim marrjeje gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve në mjedis në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.* Procesi i vlerësimit duhet të jetë i përgjithshëm, i integruar, në kohë, i hapur dhe të realizohet në mënyrë të paanshme nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, publikut, si edhe organizatave mjedisore jo fitim prurëse, e zhvilluesve të projekteve si edhe të personave fizikë dhe juridikë të specializuar në këtë fushë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e ndikimit mbi mjedis.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin
Ligje:

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Ligji Nr. 12/2015, datë 26.2.2015 "Për disa ndryshime në ligjin “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Ligji Nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".

Ligji Nr.111/2012, datë 15.12.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ligji Nr. 8906 “Mbi Zonat e Mbrojtura” dhe përmiresuar me Ligjin 9868 date 04.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e mesipërm për Zonat e Mbrojtura”.

Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”.

Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2007 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”.

Ligji Nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9385 “Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor”.

Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”.

Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura.

Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

Vendime të Këshillit të Ministrave:

V.K.M Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

V.K.M Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

V.K.M Nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të Lejeve të mjedisit”.

V.K.M Nr. 227, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave dhe të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.

V.K.M Nr. 175, datë 19.01.2011 ”Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”.

V.K.M Nr. 587, datë 7.07.2010 ”Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbanë dhe turistike”.

V.K.MNr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”.

V.K.M Nr. 853, datë 28.12.2005 “Për miratimin e listes se mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera që ndalohen të importohen me qëllime ruajtje, depozitimi dhe asgjësimi”.

V.K.M Nr. 248, datë 24.04.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe zbatimin e tyre”.

V.K.M Nr. 435, datë 12.09.2002 “Për Miratimin e Normave të Shkarkimeve në Ajër në Republikën e Shqipërisë”.

V.K.M Nr. 103, datë 31.03.2002 “Mbi Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzime dhe Rregullore:

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Financave Nr. 7938, datë 17.7.2014 'Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”.

Udhëzim i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Nr. 8 date 27.11.2007 ”Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

Gjithashtu, Shqipëria është palë e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi Biodiversitetin, Ndryshimet Klimatike, procesin e shkretëtizimit, Specie në rrezik, Mbetjet e dëmshme, Ligjin mbi detin, Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Lagunave.

Gjate hartimit të këtij raporti VNM-je, janë marre në konsideratë edhe disa nga Direktivat kryesore të BE-se për mjedisin:

- + Direktiva 1999/30/CE date 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit. (Council Directive 1999/30/EC of 22 April 1999 relating to limit values for sulphur dioxide, nitrogen dioxide and oxides of nitrogen, particulate matter and lead in ambient air).
- + Direktiva 2000/60/CE datë 23 Tetor 2000 për Kuadrinligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave. (*Directive 2000/60/EC of 23 October 2000 of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy*).
- + Direktiva 2001/42/CE datë 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin. (Directive 2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27 June 2001 on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment).
- + Direktiva 2011/92/EU e datës 13 Dhjetor 2011 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve publike apo private (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).
- + Direktiva 2008/50/CE datë 21 Maj 2008 Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”. (*Directive 2008/50/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe*).

- ✚ Direktiva 2014/52/EU datë 16 Prill 2016 mbi disa ndryshime ne Direktiven 2011/92/EU mbi VNM (Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment). (Directive 2014/52/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 amending Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment).

Legjislacioni për Planifikimin Territorial

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, datë 09.7.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ka për qëllim:

- a. Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b. Të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;
- c. Të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e private.
- c. Të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;
- d. Të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;
- e. Të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;
- f. Të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Ligji i lart-përmendur specifikon që Autoriteti i planifikimit vendor përcakton në planin e përgjithshëm të territorit zonat, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të planeve të detajuara vendore, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit. Planet e detajuara vendore hartohen me qëllim: a) zhvillimin dhe/ose rihzhvillimin e një zone/njësie; b) rigjenerimin/ripërtëritjen e një zone/njësie kryesisht urbane; c) ndërtimin e infrastrukturave publike.

Hartimi i kesaj VNM është bazuar gjithashtu edhe ne vendimet e meposhtme:

V.K.M Nr. 271, datë 6.4.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar.

V.K.M. Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

V.K.M. Nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.

V.K.M. Nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

Ligji i Planifikimit të Territorit dhe rregulloret e tij përcaktojnë tre tregues të distancave:

- a. Distanca midis 2 ndërtesave/strukturave.
- b. Distanca midis një ndërtese dhe kufirit të pronës, dhe
- c. Distanca midis një ndërtese dhe kufirit të rrugës.

Distancat janë shumë të rëndësishme, pasi kur zbatohen sigurojnë ajrim të mjaftueshëm për banesat, hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur në rrugë dhe hapësirë të mjaftueshme për gjelbërim dhe aktivitete argëtuese për fëmijët apo të gjitha moshat.

1. Distanca minimale midis fasadave të dy ndërtesave pa dritare dhe asnjë lloj çarjeje, është 4 metra. Dy ndërtesa mund të jenë edhe të bashkëngjitura. Në zona ekzistuese të qytetit, nëse midis dy ndërtesave nuk ka rrugë apo sheshe, distanca minimale është 10 metra.

Distanca minimale midis një ndërtese dhe kufirit të pronës është 2 dhe më shumë metra, sipas rasteve që parashikojnë rregulloret e ligjit të planifikimit.

Në zona që ndërtohen rishtazi, distanca minimale midis dy ndërtesave është e barabartë me lartësinë e ndërtesës më të lartë, e matur në metra. Distancat minimale e ndërtesave nga trupi i rrugës është 5 dhe më shumë metra, sipas rasteve që parashikojnë rregulloret e planifikimit të territorit dhe Kodi Rrugor.

Distanca minimale e ndërtesave nga hekurudha varion nga 25, në 100 metra dhe më shumë, sipas rasteve që parashikojnë rregulloret e Ligjit të Planifikimit.

Legjislacion për Trashëgimime Kulturore

Përsa i përket Trashëgimisë Kulturore, legjislacioni bazë është: Ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ne territorin e Republikës së Shqipërisë.

Karakterizimi i trashëgimisë kulturore, vlerat e lidhura me të dhe politikat vijuese për mbrojtjen dhe trajtimin e saj janë paraqitur në dokumente të ndryshme ndërkombëtare të UNESCO-s, nga të cilat më të rëndësishmet janë një seri Rekomandimesh dhe Konventash. Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar mbi këto politika është Karta Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve, e njohur si Karta e Venecias, e cila mori jetë gjatë Kongresit të Dytë të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike, që u mbajt në Venecia, në vitin 1964. (ICOMOS-i, i themeluar në vitin 1965, e miratoi më vonë Kartën e Venecias si udhëzuesin e tij kryesor doktrinator).

Mbi bazen e Kartes së Venecias është formuluar edhe Karta shqiptare e Restaurimit e miratuar me vendim Nr. 426, datë 13.07.2007 të Këshillit të Ministrave.

Vendimi i Kryesisë së Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 01.07.1980 dhe relacioni e planimetritë përkatëse “Për vënien në mbrojtje shtetërore të lagjeve dhe të asambleve me vlerë arkitektonike historike në qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë e Tiranë”.

Legjislacioni për Menaxhimin e Mbetjeve

Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri ka përparuar me miratimin e ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve të reja. Qëllimet dhe afatet e parashikuara nga ligjet dhe strategjitë kombëtare janë në përputhje me kërkesat e BE. Një nga objektivat e rëndësishme të kuadrit ligjor dhe arsyeja kryesore e kësaj qasje nga lart-poshtë është krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorët ndërkombëtarë (në fonde të veçanta të BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.

Ligji ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta. Për këtë qëllim, ai përcakton rregulla për trajtimin mjedisor të mbetjeve të ngurta në çdo fazë: krijimit, grumbullimit, ndarjes, transportit, riciklimit, përpunimit dhe deponimit. Ligji më tej ka për qëllim reduktimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimit të mbetjeve toksike dhe të rrezikshme. Ligji zbatohet nga:

- VKM Nr 177, datë 6 mars 2012 "Për paketimin dhe paketimin e mbetjeve".
- VKM Nr. 117, datë 13.2.2013 "Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje".
- VKM Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte"
- Urdhër Nr. 893, datë 4.10.2013 "Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vavra të përdorura".

Amenduar nga:

Ligj nr. 32/2013 datë 14.2.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Ligj nr. 156/2013 datë 10.10.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar"

Këto udhëzime nenvijzojnë nevojën për zbatimin e një hierarkie të menaxhimit të mbetjeve që përfshin parandalimin, riciklimin/ ripërdorimin; trajtimin dhe asgjësimin. Udhëzimet kërkojnë ndarjen e mbeturinave konvencionale nga mbetjeve të rrezikshme dhe në qoftë se gjenerimi i mbeturinave të rrezikshme nuk mund të parandalohet (siç është rasti në objektet e kujdesit shëndetësor); menaxhimi i tij duhet të fokusohet në parandalimin e dëmit ndaj shëndetit, sigurisë dhe mjedisit, në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Njohja dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e cdo lloj mbetje të rrezikshme të krijuar gjatë ciklit jetësor të saj të plotë.
- Sigurimi që njerëzit/firmat që merren me trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme janë ndërmarrje me reputacion dhe legjitime, të licencuara nga agjencitë përkatëse rregullatore dhe këto zbatojnë praktikën me të mira të industrisë.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret e aplikueshme.

Parimet e hartimit të VNM-es *Parimet e mbështetura në Kreun II të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";*

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;

- Parimi i kujdesit;
- Parimi i parandalimit;
- Parimi "ndotësi paguan";
- Parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar;
- Parimi i përgjegjësisë ligjore;
- Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte;
- Parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale;
- Parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore;
- Parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisore;

II. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI

Projekti “RIKUALIFIKIMI URBAN I QENDRES HISTORIKE NE VLORE, ZONA A”. Zona karakterizohet nga biodiversiteti tipik i nje zone mesdhetare. Zona e propozuar është e vendosur pranë Qendrës së Vlorës në Bashkinë e Vlorës. Përshkrimi ne vijim është projektuar për të mundësuar identifikimin e receptorëve veçanërisht atyre të ndjeshme dhe burimeve rreth vendit te propozuar që mund të jetë e ndjeshme ndaj ndikimeve që rrjedhin nga projekti.

Në brendesi te zones ndodhet vetem disa drurë dekorative të izoluar te mbjellë disa vite më parë. Megjithatë, ndërhyrjet ne Ansamblin arkitekturor nuk do të ndikojnë në këto pemë të cilat do të mbeten të paprekura.

Nderhyrjet kryesore te propozuara do te jene:

- Rikualifikimi i shesheve;
- Rikonstruksioni i rrugës “Perlat Rexhepi” dhe trotuareve;
- Rikonstruksioni i godinave; AO36 / AN24 / AN03 / BN 46 / BN 44
- Rikualifikimi i dy shesheve publike (sheshi i kullës së sahatit dhe sheshi “4 heronjtë”);







Fotografi nga zona ku eshte parashikuar te nderhyet

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit

Bashkia e Vlorës përfshin zona të rëndësishme natyrore siç është ajo e Nartës, e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit, të cilat për vetë llojshmërinë, veçantinë e llojeve që ato strehojnë dhe sasinë e

tyre të konsiderueshme, e bëjnë hapësirën e kësaj bashkie të një rendësie të vecantë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sistemi ligatinor Nartë-Vjosë me VKM Nr.680, datë 22.10.2004 është shpallur peizazh ujor/tokësor i mbrojtur, ndërsa ishulli i Sazanit përfaqëson një pjesë të Parkut Kombëtar tokë/det. Këtu dallohet sigurisht laguna, kodrat e mbjella me ullinj dhe vreshta, dallohet bimësia tipike mesdhetare, pyjet me pisha, rezervuarët me ujë të ëmbël për ujitje, dunat, fushat dhe lëndinat. Sigurisht që kjo zonë mbart një numër të madh habitatesh natyrore të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Studimet e shumta në zonën e Nartës e kanë renditur atë si zonën e dytë më të rëndësishme për shpendët e ujit në Shqipëri (Karavasta është zona më e rëndësishme) ku gjatë periudhës së dimrit strehohen një numër i madh i tyre.(më shumë se 23% e shpendëve të ujit). Narta përbën vendin më të rëndësishëm të dimërimit në Shqipëri për flamingot (*Phoenicopterus ruber roseus*), rosen laramane (*Tadorna tadorna*), rosën bishtgjele (*Anas acuta*) vraponjësën gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*) dhe gjelzën pikaloshe (*Pluvialis squatarola*). Ekosistemi natyror i Nartës shihet si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë natyrore të Evropës dhe si një kompleks i rëndësishëm ndërkombëtar. Për tri lloje, Narta kap më shumë se 1% të popullatës rajonale. Një e treta e llojeve (11 lloje) që i takon listës së “Gjitarëve Globalisht të Kërcënuar” (IUCN, 1996), tregon për rëndësinë jo vetëm kombëtare të zonës, por edhe për atë ndërkombëtare. Kjo zonë shpesh për shkak të larmisë që ofron ka qenë dhe është një zonë objekt-studimi për mjaft kërkues, studiues, institucione shkencore dhe mësimore etj. Kjo tregon për rëndësinë e lartë në nivel lokal por edhe në nivel kombëtar si dhe për disa elementë të saj edhe në nivel ndërkombëtar.

Parku Kombëtar Detar Karaburun – Sazan. Me propozim të Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, më datë 28 tetor 2010, Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 289, shpalli zonën Karaburun – Sazan si të parën zonë të mbrojtur detare (Park Detar) në Shqipëri.

Bazuar në të dhënat ekzistuese, zona e Ishullit të Sazanit dhe pjesa perendimore e Gadishullit të Karaburunit është dalluar nga zonat e tjera të ngjashme, duke u shpallur si Zona e Pare e Mbrojtur Detare në Shqipëri (ZMD). Pjesa bregdetare e Ishullit të Sazanit dhe pjesa perendimore e Gadishullit të Karaburunit mendohet të perfshihet gjithashtu në zonën e mbrojtur detare për shkak të vlerave të larta të biodiversitetit dhe habitateve të rëndësishme natyrore.

Në zonën Sazan – Karaburun gjenden të paktën 36 lloje me interes ndërkombëtar të përfshira në listat e llojeve të rezikuara dhe/apo të mbrojtura të disa konventave. Këtu përfshihen bari i detit, sfungjeret, knidaret, molusqet, krustacet, ekinodermatet, peshqit, zvarraniket, fokat dhe cetacete. Në zonën Sazan – Karaburun janë regjistruar rreth 75% e llojeve të rezikuara të kafsheve detare në shkallë kombëtare, shumica makro – invertebrore të bentosit, të cilat janë përfshirë në Librin e Kuq të Faunës së Shqipërisë (2006) dhe në listën e Kuqe të Faunës Shqiptare (2007). Në habitatet detare dhe bregdetare, në stadin mediolitoral, janë të pranishme, si në ishullin e Sazanit edhe në gadishullin e Karaburunit, biocenoza të dominuara nga *Lithophyllum byssoides*. Kjo algë e kuqe kalcike, lloj karakteristik i Mesdheut perëndimor dhe detit Adriatik, rritet pak mbi nivelin e detit, në zgavra të vogla, korridore dhe përgjate faqeve shkembore. Në këtë zonë ajo formon jastek të vegjël (masa gjysem sferike) dhe rralle formon breza, zakonisht të njohur si “trotuar”. Një tjetër biocenoze e mediolitoralit është ajo e shpellave të mediolitoralit, të cilat janë të çara apo hyrje të shpellave që janë pjesërisht jashtë ujit. Biocenoze tjetër e rëndësishme është ajo e shpellave

gjysem te erreta, ku jeton korali i kuq (*Coralium rubrum*) dhe disa lloje sfungjeresh. Biocenoza e Koraligjenit gjendet ne substratet e forta, me alga te kuqe te kalcifikuara, gorgonie dhe briozoare. Kjo biocenoze është e zhvilluar me te mire ne anen perendimore te ishullit te Sazanit dhe gadishullit te Karaburunit.


Në ujërat e zonës Karaburun–Sazan është raportuar prania e breshkave te detit, delfineve, dhe fokës së Mesdheut, të cilat janë ndër llojet më të kërcenuara në shkallë globale. Kjo zone është edhe nje korridor i rendesishem per migrimin e breshkave te detit nga zonat e tyre te folezimit ne ishujt Greke ne detin Jon per ne bregdetin e Patokut ne pjesen shqiptare te detit Adriatik, e cila se fundmi është identifikuar si nje zone e rendesishme ushqimi per këtë lloj breshke.

Brigjet e Gadishullit te Karaburunit dhe ishullit te Sazanit karakterizohen nga nje shumellojshmeri peisazesh me shkembinj te pjerret e te pakalueshem, me shpella, hone, kepe, plazhe te vogla e gjire. Keto formacione terheqese behen edhe me interesante per syrin e vizitorit fale bimbësisë se zhvilluar mire, e cila mbulon pothuajse te gjithë gadishullin qe nga maja e malit e deri ne breg. Ne Figuren 34 jepet harta e burimeve natyrore te Vlores.

Zonat e Mbrojtura dhe Zonat e Ndjeshme Mjedisore: Zona nuk është e perfshire në menyre të drejtperdrejte në asnjëren nga kategorite e zonave të mbrojtura në Shqiperi sipas kategorizimit të IUCN.

Territori në studim ku do realizohet projekti nuk sherben as edhe si zonë buferike, të cilat ruhen në perputhje me legjislacionin e Mjedisit në fuqi dhe në perputhje me politikat dhe planet qe aplikon Ministria e Mjedisit dhe ne te nuk ndodhen monumente te natyres.

Zona në studim nuk ben pjese as edhe në zonat e mbrojtura me interes të vecante qe mbrohen nga konventat nderkombetare, si; Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore (konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës); konventa boterore e trashëgimise, etj.



Harta e Burimeve Natyrore te Vlores (Burimi PPV, 2016)

Biodiversiteti

Flora

Flora dhe bimesia ne kete zone eshte shume e pasur dhe interesante. Ne zone njihen 1400 lloje te bimeve te larta (perbejne 42.4 % te gjithë flores se vendit). Kjo shpjegohet me (i) historine e vjeter te flores ne rajon (prania e llojeve terciare ose relike), (ii) ndikimi i florave te tjera si ajo e Egjeut, (iii) izolimin gjeografik te zones (male te larta dhe barriera deti) dhe (iv) me marredhenien njeri-natyre e cila eshte vendosur prej shekujsh duke krijuar habitate shume komplekse dhe te bukura (natyrore, gjysme natyrore, te modifikuara, artificiale) dhe pejsazhe

Te dhenat historike dhe ato te mbledhura nga kerkimet e fundit ne zone, tregojne per nje flore shume te pasur dhe te shumellojshme, diversitet te larte habitatesh dhe shoqerime bimesh te nje rendesie te vecante kombetare, nga pikepamja shkencore dhe ekonomike. Nje numer i llojeve bimore te zones ne studim i perkasin listes kombetare te llojeve te rralla, nje numer i konsiderueshem i bimeve dallohen per interesin e vecante shkencor qe paraqesin, ndersa shume prej tyre kane vlere te vecante ekonomike si bime mjeksore, bime etero-vajore, bime industriale, bime dekorative e keshtu me rradhe. Pavarisht nga madhesia, flora e zones Llogara -Karaburun eshte shume e pasur: 1500 lloje bimesh te larta (perfaqesojne 42.4% te flores se pergjithshme te vendit). Kjo shifer e larte shpjegohet me poziten gjeografike te zones, orografine shume te thyer dhe fomacionet e ndryshme gjeologjike, si edhe tipet e ndryshme te mikroklimave qe hasen ne zone. Shume lloje endemike dhe relike te Terciarit takohen ne zonen nen studim, si *Hypericum haplophyloides*, *Leucojum valentinum* subsp. *vlorense*, *Taxus baccata*, *Aesculus hippocastanum*, *Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis*, etj. Dy llojet e para *Hypericum haplophyloides*, *Leucojum valentinum* subsp. *vlorense*, jane endemike vetem per zonen e Projektit.

Zona ne studimit perfaqeson nje kryqezim te rendesishme te rrugeve migruese te flores se rajonit te Ballkanit. Nje numer llojesh takohen ketu me kufijte e tyre me veriore te shperndarjes, si *Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis*, *Abies borisii* – *regis* etj. Lloje te tjere si *Petteria ramentacea*, kane ketu kufirin me jugor te perhapjes se tyre. Disa lloje si *Aesculus hippocastanum*, kane ketu kufirin me perendimor, ndersa disa te tjera (*Teucrium fruticans*, *Brassica incana*) ka ketu kufirin e tyre me lindor.

Rreth 102 specie bimesh ose 21.25 % e gjithe llojeve te rralle dhe te rrezikuar ne Shqiperi (330 lloje) takohen brenda kesaj zone studimi. Kerkimet tregojne se flora e zones nen studim ka afersi te fuqishme floristike me shumicen e vendeve te Ballkanit jugor; me shume se 24 lloje te gjendura ne Greqi, e kane pjesen me te madhe te arealit te tyre verior ne kete zone

Fauna

Te dhenat e paplota per invertebroret te mbledhura ne kuadrin e Site Diagnosis te Zones u takojne atyre te insekteve. Jane raportuar ne zone 151 lloje qe i takojne rendit Coleoptera, dhe 93 lloje te rendit Lepidoptera (fluturat dhe fluturat e nates). Ekziston nevoja per kerkime shkencore te metejshe dhe pune ne terren per studimin e pasurise llojore te invertebroreve, vecanerisht per molusqet dhe insektet (grupe te tjera pervec atyre te permendur me siper).

Amfibet dhe Reptilet. Ne kete zone gjenden 10 lloje Amfibesh (nga 15 qe njihen ne gjithe vendin) dhe 28 lloje Reptilesh (nga 37 lloje qe njihen ne gjithe vendin). Herpetofauna e pasur dhe e shumellojshme shpjegohet me pozicionin gjeografik, kushtet e favorshme klimaterike dhe larmine e habitateve

Shpendet. Ne studime te ndryshme ones jane raportuar rreth 105 lloje shpendesh, por besohet se ky numer duhet te jete me i larte (numri i pergjithshem i shpendeve qe njihen ne vend vleresohet te jete rreth 330 lloje). Bazuar ne statusin sezonal, ornitofauna perbehet nga:

- 63 lloje rezidente ose 60 % e gjithe llojeve
- 30 “vizitore verues” ose 28.6 % e gjithe llojeve
- 11 lloje “dimeronjes” ose 10.5 % e gjithe llojeve
- 1 lloj “shtegtar” ose 0.9 % e gjithe llojeve

Shpendet ujore (kryesisht ata te lagunes se Orikumit) dhe shpendet detare perbejne nje element te rendesishem te biotave dhe habitateve te lagunes. Zona ofron habitate te pershtatshme per nje numer shpendesh grabitqare, ku ben pjese edhe *huta*. Shpendet e pyjeve te lidhur me pyjet e vjeter, si *qukapiku* dhe *harabeli*, jane mjaft te perhapur ne zone. Te gjitha keto e bejne zonen mjaft terheqese per te apasionuarit e shpendeve.

Gjitaret. Pavaresisht nga te dhenat e paplota, kompleksi Llogora-Rreza e Kanalit-Dukat-Orikum-Karaburun perfaqeson nje nga zonat me te rendesishme te vendit persa i perket gjitareve 55 lloje nga 71 te njohur ne te gjithe vendin, pritet te shihen ne zone, nderkohe qe 42 jane tashme te raportuar.

Sipërfaqet e gjelbra në zonën e projektit

Zona e projektit, i cili shtrihet në zonën urbane të Vlorës, nuk karakterizohet nga habitate pacenuara ose natyrore, peisazhe me vlera të rëndësishme skenike apo biodiversiteti (florës dhe faunës) me interes për ruajtje. Ne figuren janë paraqitur sipërfaqet e gjelbra në zonën e projektit.


III. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ

Zona mbi të cilën fokusohet projekti, ndodhet në qytetin e Vlores. Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë dhe është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200.000 (2013). Vlora është qendra e Rrethit të Vlorës dhe të Qarkut të Vlorës dhe qyteti më i rëndësishëm ekonomik dhe kulturor i Shqipërisë jugperëndimore. Është qyteti ku është shpallur Deklarata e Pavarësisë shqiptare më 28 Nëntor, 1912. Në Figure është dhënë harta e Bashkisë Vlore dhe pozicioni i zonës së projektit në këtë bashki.

Ujërat sipërfaqësorë në këtë rajon përfaqësohet kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, veri të lagunës së Nartës.

Objekti ynë ndodhet rreth 5.3 km larg nga laguna e Karavastas, 2.3 nga ujembledhësi i zonës dhe 3.0 km nga Deti Jon.





Pozicionimi ne lidhje me burimet ujore



Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj


Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat menaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore. Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për

shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj dhe zënë rreth 16% të teritorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:

- a) Të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve,
- b) Të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve,
- c) Të ketë përfaqësueshmëri,
- d) Të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit,
- e) Të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet,
- f) Të ketë vlera shkencore;
- g) Të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme,
- h) Të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike,
- i) Të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe
- j) Të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në Shqipëri, zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim përmban zonat e mbrojtura si mëposhte:



Harta me zonat e mbrojtura te Republikes se Shqiperise

Klima

Klima perben një element shume të rendesishem si në formimin e zhvillimin e bimesise, ashtu edhe per fenomenin e erozionit. Ndër faktorët që ndikojnë në formimin e klimes mund të rendisim: *Rrezatimi diellor* (sasia dhe intensiteti) që percaktojnë karakteristikat themelore të klimes.

Relievi, ndikimet e tij janë në qarkullimet malore e luginore si dhe në masat ajrore. Rrjedhim i drejtperdrejte i relievit janë tërë ato ndryshime qe verehen në vlerat e elementeve metereologjike, brenda hapesirave të vogla e shume të vogla (mikroklimat). Shpatet perendimore marrin 300-600 mm reshje me tëper nga shpatet lindore.

Gradientet vertikale të tëmperatures se ajrit lekunden ndermjet 0.4-0.6 °C/100 m. Ndryshime të theksuara verehen në vlerat mujore të tyre.

Orientimi dhe kendi i pjerresise se shpateve luajnë rol të rendesishem në sasinë e rrezatimit të pergjithshem diellor qe ato marrin. Shpatet jugore, në vecanti gjate muajve nëntor, dhjetor e janar marrin 3-4 here me shume nxehtesi se ato veriore, në të njëjtin kend pjerresie. Sasia me e madhe e nxehtesise fitohet kur pjerresia i kalon 45 ° (60-65 °).

Perberja e mbuleses dhe bimesia janë faktor qe ndikojnë në formimin e klimes. Bimesia është faktori klimatik qe ndodhet në lidhje të ngushte e të ndersjellte me klimen. Klima luan rolin percaktues, nga ajo m’varet zhvillimi dhe perhapja e bimesise. Vete mbulesa bimore ka ndikim të jashtezakonshem mbi klimen. Në vere bimesia e mbron tokën nga të nxehtit e diellit. Keshtu që temperatura e tokës rezulton me e ulet se ajo e një tokë të zhveshur. E kunderta ndodh gjate nates. Gjithashtu lageshtira e ajrit në viset e veshura me bimesi është me e larte se në ato të zhveshura. Në vijim jepen disa tregues të klimes: diellëzimi, temperatura, rreshjet dhe ererat në qytetin e Vlorës.

Diellëzimi

Shqiperia dallohet per sasinë e madhe të oreve me diell. Vlerat e sasise vjetore luhaten nga 2000 ore në zonat malore (Kukes) deri në 2841 ore në ultesiren bregdetare të vendit (Fier). Vlerat me të vogla janë në dhjetor qe perkon me zgjatjen e dites.

Në zonën qe merret në studim ndikim të madh në zgjatjen e diellzimit ka pozicioni topografik. Edhe vranësirat ndikojnë në zgjatjen faktike të diellzimit. Të dhenat qe jepen në forme numerike në Tabelen me poshte (Tabela) u janë referuar të dhenave 50 vjecare të stacionit metereologjik të Vlorës.

Tabela. Sasite Mujore dhe Vjetore të Rrezatimit të Pergjithshem per Vloren

Muaji	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Kor	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Vjetore
Energjia diellore mesatare (kWh/m ² /d)	3.6	4.19	5.11	5.59	6.62	7.59	7.67	6.89	5.9	4.71	3.56	2.92	5.12
Numri i diteve	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
Energjia diellore mesatare (kWh/m ²)	117.09	112.53	145.8	145.2	179.17	208.41	217.36	193.4	156.42	137.45	102.34	91.93	1721.46

(Burimi: Halili, 2016)

Baza e arkitekturës bio-klimatike është studimi i faktorëve natyrorë që ndikojnë në klimën e zonës ku do të projektohet, në mënyrë që rezultati të plotësojë të gjitha kërkesat e parashtruara. Duke u bazuar në termat e referencës, pajtueshmeria me natyrën është një nga kërkesat më të rëndësishme.

Përpara se të studiohen strategjitë bio-klimatike bëhet një analizim i rrugës së diellit gjatë një viti, e quajtur diellëzim, i cili na ndihmon të vendosim orientimin e ndërtesave dhe shpërndarjen e funksioneve në brendësi të tyre.

Përgjithësisht ambientet që kanë nevojë për më shumë ndricim natyral të drejtpërdrejtë janë dhomat e ndenjes dhe kuzhinat në brendësi të apartamentit. Ndërsa në qoftë se flasim për organizimin e një pallati, pergjithësisht shkallët dhe ashensorët janë ato që pozicionohen në pjesën veriore ku nuk ka ndricim natyral të drejtëpërdrejtë. Përcaktimi i saktë i orientimit të ndërtesës ndihmon në arritjen e nje efience energjitike.




Figure. Studimi i diellëzimit gjatë një viti nëpërmjet grafikut karteziar

Temperatura

Vlora ka një klimë të ngrohtë dhe të moderuar (Csa mesdhetare në klasifikimin e klimës sipas Köppen & Geiger). Gjatë rrjedhës së një viti, temperatura zakonisht varion nga 5°C deri 33 °C dhe është e rrallë më poshtë 0°C ose më lart 35°C. Nga grafiku i mëposhtëm duket qartë se pjesa e thatë e vitit përkohet me periudhën qershor-gusht ndërsa periudha më e lagësht korrespondon me stinën e vjeshtës dhe atë të dimrit me një maksimum në muajin dhjetor. Këto karakteristika të rreshjeve e kategorizojnë bashkinë e Vlorës si një bashki me tipare të theksuara mesdhetare.




Figure. Mesataret e temperaturave në qytetin e Vlorës.

Në figurën e mësipërme janë paraqitur temperaturat mesatare mujore të ulëta (ngjyre blu) dhe të larta (ngjyre të kuqe). Sezoni i ngrohtë zgjat nga 1 qershor deri më 15 shtator me temperaturën mesatare më të lartë ditore mbi 28 °C. Dita më e nxehtë e vitit është 21 gusht me një mesatare të lartë 32 °C dhe të ulët prej 18 °C. Sezoni i ftohtë zgjat nga 10 dhjetor deri në 14 mars me temperaturën mesatare më të lartë ditore nën 15° C.

Reshjet

Në diagramat e mëposhtme janë dhënë treguesit e reshjeve dhe karakteristikat e tyre. Si vecori e përgjithshme e reshjeve është se ato janë me tëper në shpatet perendimore e juperendimore të maleve dhe me pak në shpatet lindore. Një shpërndarje e tillë është e lidhur me vendosjen e relievit dhe trajektoreve të levizjes së ciklonëve. Zakonisht dimri i vjeshta janë të lageshta, pranvera e paqendrueshme dhe vera është e thate. Probabiliteti i rënies së reshjeve në këtë vend ndryshon gjatë gjithë vitit. Reshjet është më e mundshme të ndodhin në 50 % të ditëve rreth 7 dhjetor. Reshjet kanë më pak të ngjarë të bien rreth 3 gusht, vetëm në 18 % të ditëve.

Grafiku më poshtë (Figura) tregon për çdo muaj numrin e ditëve me diell, pjesërisht me re, të mbuluar me re dhe me reshje. Ditë me mbulesë me re më pak se 20 % konsiderohen si dite me diell, 20-80% mbuluar me re si pjesërisht me re dhe më shumë se 80 %, si të mbuluara me re.




Figure. Numri i diteve me diell, vranesi dhe me reshje sipas muajve

Gjatë tërë vitit, format më të zakonshme të reshjeve janë stuhite, shira të lehta, dhe shiu i moderuar. *Stuhitë* janë reshjet më të rënda vërejtur gjatë 40% të atyre ditëve me reshje. Ata kanë më shumë gjasa të ndodhin rreth datës 14 qershor, kur është vërejtur gjatë 23% të të gjitha ditëve. *Shirat e lehtë* janë më të shpeshtë dhe janë vërejtur gjatë 30% të atyre ditëve me reshje. Kjo është më e mundshme rreth 27 dhjetor, kur është vërejtur gjatë 18% të të gjitha ditëve. *Shiu i moderuar* janë vërejtur gjatë 26% të atyre ditëve me reshje. Probabiliteti më i madh për këtë lloj reshjesh është rreth 23 dhjetor, kur është vërejtur gjatë 18% të të gjitha ditëve.

Erërat

Gjatë periudhës së ftohtë të vitit sidomos në muajin Janar erërat fryjnë kryesisht në drejtim të Lindjes dhe Veri- Lindjes (L-VL) me një shpejtësi mesatare prej 3.5 m/s dhe gjatë verës në

drejtimin Veri- Perëndimor dhe Perëndimor (VP-P) me një shpejtësi mesatare rreth 4.8 m/s. Erërat perëndimore karakterizohen nga briza bregdetare në stinën e verës.

Sipas Institutit Meteorologjik Shqiptar në Bashkinë Vlorë sasia vjetore e orëve me erëra varion sipas zonave nga një vlerë minimale prej 1000 orësh deri në një vlerë maksimale prej 4500 orësh (Figura 28). Kjo sasi erërash në zonat me mesatare më të lartë mund të shfrytëzohet për ta shndërruar energjinë mekanike të erës në disa forma të tjera të energjisë dhe që mund të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike, për mullinj, etj. Kjo energji e rinovueshme dhe e pastër do të kursente sasi të mëdha të emetimit të CO₂ në atmosferë dhe do të zëvendësonte rolin e një pylli apo një sipërfaqeje ekuivalente të gjelbërt (Figura 28). Zonat me 4500 orë/vit mund të konsiderohen si zona të gradës së 1 deri 3 (nga 7 që është më e larta).




Figure. Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë (majtas); Harta territoriale e orëve me diell (djathtas)




Figure. Shpejtesia e erës

Diagrama për Vlorën (Figura) tregon numrin e ditëve brenda një muaji që mund të pritet që erërat të arrijnë shpejtësi të caktuar, ndërsa trendafili i erës (Figura) tregon frekuencën e erërave sipas drejtimeve.




Figure. Trëndafili i erës për Vlorën

Tabel. Të dhënat klimaterike për Vlorën

Të dhënat klimaterike për Vlorën (1961–2000)												
Muaji	Jan	Shkurt	Mar	Pril	Maj	Qer	Kor	Gus	Shta	Tet	Nen	Dhje
Temperatura mesatare (°C)	9.1	9.9	11.3	14.3	18.3	22.4	24.3	24.1	21.2	17.4	13.7	10.6
Temperatura minimale (°C)	5.7	6.4	7.5	10.1	13.9	17.6	19.3	19.1	16.6	13.3	10.1	7.2
Temperatura maksimale (°C)	12.5	13.4	15.2	18.5	22.8	27.2	29.3	29.2	25.9	21.6	17.3	14.1
Lageshtia relative (%)	56	54	57	55	56	51	48	46	50	54	62	60
Numri i diteve me reshje (probabiliteti i shiut ne nje dite)	13 (42%)	12 (42%)	14 (45%)	11 (37%)	9 (29%)	6 (20%)	3 (10%)	3 (10%)	5 (17%)	10 (32%)	17 (57%)	17 (55%)
Perqindja e oreve me diell (vranesira) gjate dites	45 (55)	44 (56)	48 (52)	56 (44)	62 (38)	69 (31)	82 (18)	82 (18)	73 (27)	63 (37)	39 (61)	35 (65)
Mesatarja e reshjeve (mm)	134	105	82	64	54	27	16	25	59	109	161	147
Source #1: Meteo Climat (record highs and lows) ⁱ												

Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia

Zona në studim përfshihet në pjesën jugore të Ultësirës Perëndimore. Në sipërfaqe takohen kryesisht depozitime të Kuaternarit të përfaqësuar nga sedimente detare të Plaistocenit dhe detare e kontinentale të Holocenit. Depozitimet Kuaternare janë të natyrave detare e kënetore ku këto të fundit janë mbizotëruese. Ato mbulojnë strukturat antiklinare e sinklinare të UPA. Në thellësi të rajonit në studim takohen depozitime rrënjësore të sistemit Neogjenik. Rajoni Vlorë-Nartë nga pikëpamja hidrogeologjike përfshihet në pellgun e madh artesian të Ultësirës Perëndimore, i pasur me ujra nëntokësor të kushtëzuar si nga prania e shkëmbinjve kolektor ashtu dhe nga kushtet klimatike me rreshje atmosferike.

Bazuar mbi të dhënat gjeologjike dhe hidrogeologjike të marra mbi ujëmbajtjen në rajon, veçohen tre nivele ujëmbajtëse të cilat nga lartë poshtë janë:

- Horizonti ujëmbajtës i rërave bregdetare
- Horizonti ujëmbajtës i rërave lagunore e kënetore
- Horizonti ujëmbajtës me presion i zhavoreve

Ne baze të studimeve të disponueshme gjeografike, gjeologjia rajonale ndërmjet Elbasanit dhe Vlores përbehet: 35% nga shkëmbinj detare sedimentare, 35% nga shkëmbinj ultra të thjeshtë dhe 35% nga shkëmbinj detare sedimentare me segmente llave. Terreni ndërmjet Lushnjes dhe Elbasanit përbehet nga forma të ndryshme shkëmbinjsh detare sedimentare. Sipërfaqja gjeologjike ndërmjet vendit të përzgjedhur dhe Lushnjes përbehet kryesisht nga sedimente detare dhe nga sedimente lumore jo të ndara. Pjesa bregdetare e bllokut nga Vlora në Poro përbehet nga rera kuaternare detare dhe zhavorr në kepet molase tretësore. Molasa është depozituar në Gropen Prane-Adriatikut, që mbulon sedimente të vjetër karbonati. Molasa përben gjithashtu dhe pjesën kodrinore të zonës. Molasa përbehet nga gure ranore, gure balte, nga shist argjilor dhe argjile për cimento. Gipsi del mbi tokë afër Nartës aty ku ndodhet një gurorë e vogël e abandonuar. Në fundin e pjesës veriore të Lagunes së Nartës janë gjetur depozitime të kënetave kuaternare. Aluvion kuaternar dhe i koheve të fundit është gjetur në lumenjtë e lumenjve Shushice dhe Vjose. Këto sedimente përbehen kryesisht nga rere të ashpër dhe gure gelqerore. Sedimente me të holla gjenden në pjesën me shkajore të luginave. Prane Kaninës dhe Drashovicës del mbi tokë gur gelqeror me i vjetër Tretësor dhe mesozoik. Ky gur gelqeror është rezistent ndaj erozionit dhe është germuar në disa zona për gelqerë, materiale ndërtimi dhe mbushje.

Pjesa perëndimore e Vlores dhe zona e centralit që janë në kufi me Detin Adriatik janë pjesë e sinklinalit të Nartës. Zona kodrinore në lindje është pjesë e antiklinalit Trevllazri. Sinklinali i Nartës përbehet nga depozitime kuaternare dhe Neogjene. Në përgjithësi, depozitimet e Neogjenit përbehen nga argjile, gure argjilore, gure ranore dhe konglomerate. Depozitimet kuaternare përbehen kryesisht nga balte dhe rere argjilore. Në përputhje me rezultatet e investigimeve të mëparshme mbi përberjen e tokës, trashësia maksimale e depozitimeve kuaternare është rreth 90m. Seksioni me I poshtëm I depozitimeve Katësore përmban shtresa

thellë dhe janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të fshatrave, pasi uji i rrjetit është mjaft i ndotur si pasojë e amortizimit shumëvjeçar të tij dhe si pasojë e mungesës së investimeve të rehabilitimit. Në Novoselë fortësia e këtyre ujërave rezulton Fp nga 15.01-15.43°gj; ndërsa përmbajtja në Ca rezulton e lartë në vlera nga 52.14-97.08mg/l. Tendencia e rrjedhjes së këtyre ujërave është drejt perëndimit në detin Adriatik. Mungesa e kanalizimeve të ujërave urbane dhe e mos trajtimit të tyre paraprak përbën një rrezik të madh për cilësinë e këtyre ujërave dhe përdorimin e tyre për ujë të pijshëm. Në përgjithësi rreziku i ndotjes përcaktohet si mesatare.




Figure. Harta e rrjetit hidrografik

Ujërat sipërfaqësore

Ujërat sipërfaqësore në këtë rajon përfaqësohet kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, veri të lagunës së Nartës. Kjo pasuri e madhe ujore sot po degradon sidomos në pjesën e saj që gjarpëron në këtë Bashki si pasojë e aktivitetit të kompanive të inerteve por edhe si pasojë e ndotjeve (ujërave të zeza etj) që vijnë nga komunat dhe fshatrat (rreth 40 të tilla) përreth luginës së tij. Ndotja ka ndryshuar ekosistemin duke sjellë si pasojë më të dukshme, shfarosjen e rrapit lumor. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë. Nga monitorimet e raportuara në raportin mjedisor 2014 të kryera në pesë pika(stacione) të ndryshme si Mifol,

Carshovë, para derdhjes në det etj, të realizuara me një shpeshti prej më së paku tre herë në vit rezultojnë se NBO5 është në vlera të ulta që variojnë nga 2-3mg/l me një tendencë në rritje në vite; vlerat NKO janë të ulta nga 3.5 deri në 6.8mg/l; fosfori total me vlera nga 0.014 deri 0.029 mg/l; përmbajtja me NO2 rezultojnë në vlera shumë të ulta; për nga përmbajtja e NH4 ky basen rezultojnë i cilësisë së dytë me vlera që shkojnë nga 0.049 deri 0.123mg/l; në përgjithësi gjendja e këtij baseni konsiderohet akoma e mirë por me tendencë rritjeje të ndotjes nga Carshova në grykë-derdhje në det. Një numër masash urgjente, përveç gjëritjes, duhen ndërmarrë për të parandaluar një katastrofë ekologjike. Lumi disa herë ka përmblytur zonat përreth duke shkaktuar dëme të mëdha në kompanitë e inerteve dhe në ekonomitë e vogla bujqësore. Këto masa duhet të sjellin parandalimin e hedhjes së mbeturinave, parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në luginën e lumit si dhe reduktimin e nxjerrjes së inerteve nga luginat e tij.

Lumi tjetër i rëndësishëm është edhe ai *Shushicës* apo siç njihet ndryshe lumi i *Vlorës*, i cili është një tributar i lumit Vjosa. Në pjesën e poshtme të rrjedhjes së këtij lumi, gjërryerjet në shtratin e këtij lumi janë bërë një rrezik real për banorët që jetojnë në brigjet e tij. Kjo sjell pasoja kur bien reshje të shumta, lumi del nga shtrati duke përmblytur rrugën, por edhe shtëpitë pranë, duke prishur edhe tokat bujqësore me inertet që bart gjatë përmblytjeve. Gjithashtu të dy këta lumenj me ndotjen e tyre ndikojnë negativisht në pastërtinë e ujërave të detit në grykëderdhje. Kjo ndotje mund të sjellë pasoja negative edhe në ndotjen e ujërave të lagunave pranë.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Bazuar në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe Procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit”, MM nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik ka realizuar projektin “Monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetet kryesore të vendit tonë”. Veprimtaria studimore e monitoruese, është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Vlerësimi dhe studimi i treguesve mjedisorë të gjendjes dhe ndikimit në mjedis.
- Realizimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Cilësia e ajrit në Bashkinë Fier ndryshon sipas zonave. Në qytet dhe në afërsi të zonave të nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve vlerat e ndotjes paraqiten relativisht të larta, ndërsa në zonat rurale cilësia e ajrit është e një cilësie të mirë. Sipas AKM-së, gjatë viteve 2002-2014, duke përjashtuar këtu vitin 2013, në qytetin e Fierit janë monitoruar gjashtë parametra të cilat janë PM10, SO2, NO2, O3, LNP dhe PB184. Të dhënat e përftuara nga monitorimi i vazhdueshëm ndër vite, tregojnë një përqendrim mbi normat e BE-së dhe ato shqiptare të katër elementëve ndotës në ajër, **LNP**, **PM10**, **O3** dhe **SO2**. Vlerat e Ozonit dhe dioksidit të sulfurit paraqiten në rënie vitet e fundit. Në 2011, vlerat e SO2 paraqiten brenda normave kufij të BE-së dhe ato shqiptare, ndërsa O3 ka tendencë rënieje. Vlerat e parametrave LNP dhe PM10 vazhdojnë të mbeten të larta duke tejkaluar me 2-3 herë normat e BE-së.

Vlera mesatare e parametrave të monitoruar ndër vite	Parametrat e monitoruar (në $\mu\text{g}/\text{M}_3$)					
	SO ₂	NO ₂	Pb	O ₃	LNP	PM ₁₀
2002	21	21	0.23	51	258	109
2003	19.75	18	0.21	73.5	215	92
2004	18.5	15	0.19	96	172	75
2005	18	23	0.25	100	203	93
2006	24	25	0.29	100	219	106
2007	25	24	0.25	98	213	102
2008	32	33	0.32	70	238	112
2009	33	27	0.25	74	225	110
2010	26.7	31	0.24	62.6	195	93
2011	19.6	31.5	0.23	76	185	89
2012	20	25		74	221	97
2014		25.33				95
Norma R.SH ¹⁸⁵	20.00	40	1	40	140	40
Normat BE ¹⁸⁶	20.00	40	0.5	40	90	40

Tabela e vlerave mesatare të treguesve të monitoruar nga 2002-2014 ne Bashkinë Fier dhe normat e lejuara të BE-së dhe Shqipërisë.

Cilësia e Ajrit

Mbyllja e shumë prej industrive të Vlorës ka pasur një efekt pozitiv për sa i takon cilësisë së ajrit. Megjithatë, zhvillimet ekonomike dhe sociale pas vitit 1991, vecanerisht rritja e numrit te automjeteve dhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje serioze të ajrit në qytet.

Ndërtimi kontribuon në një masë të madhe në përkeqësimin e cilësisë së ajrit ne qytetin e Vlorës. Një çështje tjetër madhore e cilësisë së ajrit ka lidhje me veprimtaritë ndërtuese. Ndërtimi rrit gjithashtu dhe ndotjen nga automjetet, si rezultat i qarkullimit të shumë automjeteve te renda.

Në Bashkinë Vlorë mund të thuhet se cilësia e ajrit është relativisht e kënaqshme. Bazuar në raportin mjedisor të vitit 2014 në qytetin e Vlorës, ku edhe parametrat mjedisorë janë më të kërcënuar se sa në zonat e tjera të bashkisë, rezultojnë në nivele brenda normës së BE dhe asaj kombëtare pothuaj për të gjithë elementët ndotës të ajrit.

Ndotja nga PM10 dhe PM2.5 sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkerive.

Kështu grimcat PM10 dhe PM2.5 rezultojnë brenda normës BE prej ($40\mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe $25\mu\text{g}/\text{m}^3$) dhe nuk ka as edhe një ditë tejkalim të kësaj norme. Tabela në vijim (Tabela) jep nivelet PM10 (shprehur ne $\mu\text{g}/\text{m}^3$), në pjesë të ndryshme të qytetit. PM10 është sasia ne peshe e grimcave me diameter deri ne 10 mikron (μ) në një metër kub ajër.

Nr	Vendi	PM10 ug/m3		PM2.5 ug/m3	
		2014	2015	2014	2015
1	Qendra e Vlorës	15.29	7.61	10.55	7.61
3	Standardi Shqiptar	60		15	
4	EU Standard	40		25	

Tabela. Vlerat mesatare vjetore per grimcat

Burimi: Ministria e Mjedisit

Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohës vjetore. Të dhënat e monitorimit për pluhurat (PM10 dhe PM2.5) realizohen ne baze orare. Në grafikët e mëposhtem paraqiten të dhënat mesatare për treguesit e monitoruar.

Përqendrimet ditore të SO₂, përgjegjës për shirat acide, janë përsëri nën vlerën normë ditore të BE prej 125µg/m³ dhe nuk ka patur tejkalime as orare dhe as ditore. Po ashtu nivelet e NO₂ janë nën vlerën 40µg/m³ të BE. Situatë të ngjashme paraqesin edhe gazet si O₃, CO, benzenet etj. Bazuar nga vlerat e marra në vite për qytetin e Vlorës trendi paraqitet dukshëm në rënie. Kjo vjen nga mungesa e një industrie të mirëfilltë, nga mosfunksionimi i TEC-it (Tabela).

Table. Vlerat mesatare vjetore per ndotesit kryesore

Ndotësit (µg/m ³)	SO ₂		O ₃		CO		NO ₂		Benzen	
	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015
Vlorë	8.05	8.44	63.65	79.72	0.37	0.37	10.41	12.62	0.91	1.44
Standarti i BE	125		120		10		200		5	

Burimi: Ministria e Mjedisit

Ndotësit Fotokimik. Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësive primare dhe përbërësve të tjerë të atmosferës.

Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të

konsideruëshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e auto-mjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.

Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës. Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Ndotja akustike

Ndotja akustike i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dBA (në zonat të dendura të trafikut rrugor). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor “i dukshëm”. Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Ndotja akustik ka efekte negative mbi shëndetin, në të njëjtën kohë direkte dhe të grumbulluara (të akumuluar).

Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallojë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB).

Niveli i zhurmave urbane (LAeq): është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Monitorimi i zhurmave urbane kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka për qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 8 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohej mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës bezdisen.

Në këtë rast, zhurma në komunitet, bëhet një problem i vërtetë i shëndetit mjedisor. Edhe në vendin tonë, zhurma është një nga rreziqet mjedisore, që vazhdon të evoluojë dhe mund të krijojë probleme tek ajo pjesë e personave që janë të ekspozuar. Veçanërisht, ndotja nga trafiku rrugor është bërë problematike dhe mjaft shqetësues.

Në qytetin e Vlorës mund të paraqitet problematike gjatë sezonit veror sidomos në rrugët ku edhe trafiku është më i renduar.

Table. Niveli i zhurmave në qytetin e Vlorës [dB]

Pikat e monitorimit	2007	2008	2010	2011	2014
Hyrja e Qytetit	70	60.9	62.6	60.6	62.8
Përballë Xhamisë	68	70.5	64.2	62.4	58.9

Përballë Hotel Bolonjës	71	65.5	64	66.7	59.8
Tek Uji i Ftohtë	69	68.4	59.1	57.6	67.2
Standarti i BE	55				

Burimi: Ministria e Mjedisit

Sidoqoftë monitorimi disavjeçar jep të dhëna (Tabela 8) se qyteti i Vlorës sot është më pak i zhurmshëm se sa në vitet e mëparshme. Situata e krijuar për shkak të ndërtimit të “lungomares” është e përkohshme dhe do të normalizohet me përfundimin e punimeve. Po ashtu edhe rehabilitimi i rrugës transballkanike do të minimizojë zhurmat që vijnë kryesisht nga lëvizja e automjeteve. Prania e TEC të Vlorës në afërsi mund të krijojë shqetësimemegjithëse teknologjia e prodhimit të energjisë sipas manualëve të paraqitura nga ekspertët e fushës nuk i kalon të 70dB gjatë ditës dhe natës. Prania e autostradës në afërsi të disa zonave të banuara të komunës krijon një shqetësim të vogël për banorët. Pajisje e autostradës në disa vende me reduktues të zhurmave nuk janë të mjaftueshme prandaj duhet menduar edhe shtimi i tyre. Kjo zhurmë është shqetësuese edhe për faunën e zonës.

Më problematike paraqitet ndotja akustike ujore pasi ardhja në port e anijeve të tonazheve të mëdha krijojnë zhurma nënujore shqetësuese për faunën. Këtu mund të përmendim anijet që furnizohen me hidrokarbure por edhe ato të peshkimit.

Zbatimi i ligjit dhe i VKM (587/2010) lidhur me monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në qendrat urbane dhe turistike do të ndikonte në përmirësimin e mëtejshëm të situatës territorin e bashkisë

Rreziku sizmik (makrozonimi dhe mikrozonimi) ne Vlorë

Makrozonimi sizmik i qytetit te Vlores

Qyteti i Vlorës ndodhet në brezin sizmik Adriatiko-Jonik, me $(PGA)_r$ të pritshme rreth 0.28 g (PNUD 2003), ndërsa sipas Hartës Sizmike të Shqipërisë (1980) intensiteti i pritshëm në ballë është 8 ballë. Gjithsesi, për shkak të tërmeteve me intensitet të lartë në të shkuarën, sikurse dhe për shkak të kushteve lokale të qytetit të Vlorës, është hartuar mikrozonimi sizmik i tij (Figura).




Figure. Harta e shpejtësive maksimale referencë të truallit të tipit A (Majtas) dhe Harta Sizmike e Shqipërisë (Djathtas) (Burimi: PNUD. 2003; Akademia së Shkencave të RSH,1980).

Mikrozonimi sizmik i qytetit të Vlorës

Sipas hartografimit të vlerave mesatare të intensitetit në ballë dhe kategoritë e trojeve në bazë të të dhënave të matjeve instrumentale dhe gjeologo-inxhinierike, qyteti i Vlorës ndahet në pesë zona:

- Zona me intensitet të pritshëm 7 ballë, që zë pjesë të vogla në zonat kodrinore në lindje të qytetit.
- Zona me $I=7.5$ ballë, 12% e sipërfaqes dhe përfshin pjesën lindore e kodrinore të qytetit dhe atë të Ujit të Ftohtë rrëzë kodrave.
- Zona me $I=8$ ballë, që zë 12% të territorit dhe shkon nga Pusi i Mezinit deri në afërsi të lagjes Skelë.
- Zona me $I=8.5$ ballë që kap 34% të territorit dhe përfshin pjesën fushore të qytetit me zgjatje meridionale.
- Zona me $I=9$ ballë, zë 37% të sipërfaqes dhe përfshin pjesën bregdetare, nga porti i vjetër te i riu, duke u zgjeruar në verilindje drejt Nartës (Koçiaj, 1987).

Kategoritë e trojeve nga pikëpamja e reagimit sizmik dhe dukuria e lëngëzimit

Sipas Kushteve Teknike të Projektimit për Ndërtimet Antisizmike, trojet nga pikëpamja e reagimit të tyre ndaj valëve sizmike në Republikën e Shqipërisë ndahen në tri kategori kryesore:

Kategoria I: a. Formacione shkëmbore: magmatike, sedimentare, efuzivo-sedimentarë, të forta, të paoksidueshme nga tektonika, karsti dhe proceset e tjetërsimit. b. Formacione flishore dhe të serisë rreshpore me fortësi mesatare të paoksiduara nga tektonika dhe tjetërsimi: ndërthurje argjilite alevrolite, ranorë dhe rreshpe, gipse, konglomeratë, ranorë me çimentim argjilor, gipsor e argjilo-ranor.

Kategoria II: a. Formacione shkëmbore me çarshmëri shumë të zhvilluar dhe shumë të tjetërsuar. b. Formacione zallishtore suargjilore të ngjeshura ose mesatarisht të ngjeshura pavarësisht nga lagështia. c. Formacione të shkrifëta: 1) Surëra, suargjila e argjila me ose pa përmbajtje të materialit coprizor, në gjendje plastike dhe elastike të fortë, me lagështi, 2) Rëra e zhavorre të ngjeshura dhe mesatarisht të ngjeshura me lagështi.

Kategoria III: a. 1) Rëra kokërrtrashë, kokërrmesme dhe kokërrimët, rëra pluhurore me nivel uji pranë sipërfaqes, 2) Argjila dhe suargjila plastike të buta deri rrjedhëse.

Në kuadër të studimeve të kryera për pakësimin e rrezikut sizmik në nivel lokal për qytetin e Vlorës, në vitet 1984-1985, është kryer vlerësimi i potencialit të lëngëzimit duke u bazuar në metoda empirike që përdorin korrelacionet e karakteristikave in-situ të trojeve me dukuritë e vrojtura dhe metoda që përdorin kushtet sforcim-deformim nëpërmjet zgjidhjeve analitike.

Qyteti i Vlorës ndodhet mbi depozitime kuaternare të dobëta me trashësi që varion nga 10-100 m. Është vënë re se këto depozitime, në pjesën e sipërme të tyre, (profilet me trashësi deri 11.5 m) karakterizohen nga nivel i cekët i ujërave nëntokësorë (0-1.5m). Për depozitimet prej rëre vlerësimi i potencialit të lëngëzimit është kryer sipas dy metodave të përmendura më sipër.

Vlerësimi i potencialit të lëngëzimit sipas korrelacioneve empirike, është kryer për gjashtë sheshe që ndodhen mbi rëra të dobëta. Potenciali i lëngëzimit sipas zgjidhjeve analitike është kryer sipas metodave Sid-Idris (1970) dhe Dobri (1982). Duke kombinuar metodat është hartuar harta e vlerësimit të potencialit të lëngëzimit të pritshëm për qytetin e Vlorës.

Zona ku ndodhen objekt i këtij punimi, nga harta e potencialit të lëngëzimit, ka potencial të ulët lëngëzimi deri në potencial zero lëngëzimi.

Trashëgimia Historike

Territori i Gjirit të Vlorës ku bën pjesë vet qyteti, prezanton një nga zonat më të pasura me monumente e site arkeologjike të Shqipërisë. Brenda qytetit të sotëm të Vlorës ruhen gjurmët e Aulonës antike mesjetare e cila rrethohet nga një sërë qendrash të tjera siç janë Treporti në veri, Kanina, Radhima, Tragjasi, Dukati dhe Oriku në lindje dhe jug ku janë zbuluar mbetje dhe gjurmë arkeologjike nga prehistoria deri në mesjetën e vonë. Këto qendra kanë qenë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Nuk mbeten jashtë ndikimeve e marrëdhënieve midis tyre edhe qendrat e mirënjohura antike më në brendësi të territorit si Amantia, Olympe dhe Cerja. Ndonëse

kërkimet dhe gërmimet arkeologjike kanë qenë të kufizuara, materiali arkeologjik i grumbulluar dhe informacionet që vijnë nga burimet e shkruara ndihmojnë të kuptojmë vlerat e mëdha historike, kulturore që ato ruajnë (Figura).



Figure. Harta e Trashegimise Kulturore per Rajonin e Vlores

Zonat e Mbrojtura Arkeologjike

Rrënojat historike janë të shpërndara brënda dhe jashtë qendrës së qytetit të Vlorës, në fshatrat përkatëse të kësaj bashkie. Këto zona të cilat mbartin një rëndësi të veçantë për vetë rrethin e Vlorës, duke marrë parasysh të gjitha vlerat dhe historikun e tyre, janë shpallur zona të mbrojtura. Në këtë rast mund të përmëndim gjashtë zona të cilat janë shpallur të mbrojtura.

Aulona e Lashtë (Vlora)

Qyteti antik gjendet në territorin e Vlorës së sotme. Gjurmët arkeologjike më të hershme që lidhen me këtë qendër datohen në shekullin e VI-V para K. Ai zinte pjesën jugore të Lagunës së Nartës (pjesën verilindore të Gjirit të Vlorës). Aulona si term do të thotë kanal, emërtim që ndoshta e ka marrë nga ekzistenca e një kanali që lidhte detin me Lagunën e Nartës gjë që dëshmohet edhe nga një gravurë mesjetare e shekullit XVI e realizuar nga Piri Reis. Gjiri i Vlorës dhe Aulona në pikëpamje strategjike ka shërbyer në antikitet për zbarkimin e ushtrive romake në luftërat kundër ilirëve e maqedonasve si dhe gjatë luftës civile midis Pompeit dhe Cezarit.

Treport (Vlorë)

Treporti prezanton një nga zonat më interesante e të veçanta arkeologjike të Bashkisë së Vlorës. Kërkimet arkeologjike tregojnë për përdorimin e territorit të Treportit nga periudhat e vjetra të gurit (Paleolitit, Mezolitit dhe Neolitit). Vendbanimi ndodhet 11km. larg bregdetit në veri të Vlorës, mbi kodrën e quajtur Pllakë. Gërmimet arkeologjike në rrënojat e Treportit para viteve 90 zbuluan jo vetëm gjurmë të qytetit antik por edhe ato të një vendbanimi prehistorik të fortifikuar. U identifikuan tre faza kryesore banimi. E para daton në periudhën, nga Epoka e Bronzit të Vonë në Epokën e Hershme të Hekurit. E dyta nga shekujt 7-5 të p.Kr dhe lidhet me vendbanimin e kodrës së Pllakës. Në fazën e tretë që daton nga shekulli i 4të para Kr në atë të shekullit të 2të pas Kr, vendbanimi zgjerohet përtej kodrës e rrethohet me një brez të ri muresh.

Orikumi (Pashalimani)

Orikumi shtrihet në bregun jugperëndimor të Gjirit të Vlorës, në këmbët e gadishullit të Karaburunit. Qyteti antik ndodhet në një kodër të ulët shkëmbore gëlqerore (e njohur ndryshe si Paleokastër), 20 m të lartë në fundin e skelës që e ndan nga gjiri i Pasha Limanit. Një kanal, tani i shndërruar në një kënetë lidhte lagunën me detin. Qyteti antik zotëron në një anë pamjen mbi portin aktual dhe nga ana tjetër lagunën. Burimet antike e lidhin themelimin e qytetit nga Eubeasit në shekullin e VI para Kr por gërmimet e fundit nuk dëshmojnë për këtë. Tit Livi përmend sesi qyteti luajti një rol të rëndësishëm, në betejën e Romakëve kundër Filipit të V të Maqedonisë si dhe në betejat e Cezarit kundër Pompeit në Orikum që janë dokumentuar në letërkëmbimet e Cezarit me Atikun. Nga monumentet kryesore të qytetit janë ruajtur gjurmë të banesave, të rrugëve dhe shkallëve të gdhendura në shkëmb, depozita uji, mure mbrojtës, portat dhe limani. Në periudhën bizantine dhe në mesjetë njihet si një port i vogël (me emrin Jeriko). Më në jugperëndim të Orikut ndodhet Kisha e Marmiroit e shekullit të XII-XIII. Me pushtimin osman Oriku u quajti Pashaliman.

Qendra Historike dhe Trashëgimia Kulturore në Vlorë

Arkitektura e Shekullit të XX

Në qytetin e Vlorës, janë të ezauruara pesëmbëdhjetë ndërtime të cilat janë shpallur monumente kulture. Teknika e ndërtimit të tyre është pothuajse e njëjtë, me kolona të brëndëshme, me çati, mure mbajtëse, konstruksione druri, mbulesë me tjegulla, përdorimi i beton-armesë etj. Vlerat estetike dhe ornamentit i kornizave janë një tjetër tipar i përbashkët i banesave të ndërtuar gjatë këtij shekulli.

Muzeu Historik

Është ndërtuar në vitin 1918 nga mjeshtra të kohës. Deri në vitin 1939 ka qënë Bashkia e qytetit. Ne vitet 1944 – 1970, në ambientet e kësaj godine kanë punuar organizatat e masave. Pas vitit 1970 u kthye në Muze Historik të Rrethit. Dallohet për vlerat historike, zgjedhjen urbane e artin e të ndërtuarit. Konstruksioni i ndërtesës është i realizuar me mure mbajtës si dhe me kollona në pjesën e brëndshme të saj. Ndërtesa është pjesërisht me çati, me konstruksion druri dhe mbulesë me tjegulla dhe pjesërisht me tarracë. Për ndërtim të soletave janë përdorur trarë si dhe qemer me tulla.

Sahati

Është ndërtuar në vitin 1918. dhe është financuar nga tregtarët e qytetit. Përveç anës funksionale ka edhe vlera estetike. Merkata dhe sahati është projektuar nga specialiste italiane. Ka shërbyer si pikë referimi për qytetin dhe qendrën tregtare. Në këtë objekt kemi futjen e strukturave dhe teknologjive të reja si betoni i armuar dhe lidhëset me cimento portland. Në vitin 1996 ndërtesa është trajtuar me punime restauruese në mjediset e brendshme dhe fasadat e jashtme. Janë me interes në këtë monument prania e ornamentikës në kornizat dhe rozetat me motive patriotike, nga të cilat vecojmë: portretin e Skenderbeut me pamje nga balli i ndërtesës, shqiponjen dykrenare me pamje nga lindja.

Monumenti i Pavaresisë.

Në qendër të qytetit ngrihet masiv i lartë prej bronzi kompleksi skulpturor 17m i lartë është inauguruar me rastin e 60 - vjetorit të Shpalljes së Pavaresisë me 28 Nëntor 1972. Vepër e Skulptoreve të Popullit Kristaq Rama, Muntaz Dhrami, Shaban Haderi. Është nga veprat më të mëdha monumentale të skulpturës në. Monumenti përjeteson kujtimin e patriotëve si brenda dhe jashtë vendit, që shkrinë jetën e tyre për pavaresinë dhe lirinë e Shqipërisë. Ka dy simbole kulmore: Në qendër patriotin – “simbol” Ismail Qemalin dhe “Flamurtarin” në krye, shenja e kurorëzimit dhe e përjetesimit të perpjekjeve të rilindasve e patriotëve të të gjitha krahinave, luftetarëve të pushkës e të penës. Aty personifikohet lavdia e të rinjve, realizimi dhe kurorëzimi i endrës së tyre – për lirinë e pavaresinë e Shqipërisë. Ngrihet mbi një platformë të gjere shumëshkallesë, me pamjen e një piramide. Në qendër Ismail Qemali: prapa tij ideologët e Rilindjes, poeti Naim Frashëri dhe luftetarë nga gjithë trevat, që dallohen nga veshja.

Ansamblu Historik ne qender te qytetit

Në qendër të qytetit janë të shpërndara ndërtesa të cilat janë evidencë e gjalle e historikut që ato mbartin. Keto ndërtesa janë akoma funksionale, edhe pse funksioni i tyre është i ndryshem nga funksioni fillestar. Teknika e ndërtimit jepet e detajuar, tek të gjithë ndërtimet e përmëndura. Duke marrë parasysh vlerat estetike, historike, kulturore, keto ndërtime janë shpallur monumente kulture me V.K.M., nr. 249, date 01/07/1980: Për vënien në mbrojtje shtetërore të lagjeve dhe ansambleve me vlera arkitektoniko-historike në qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë.

Në zonën e projektit ndodhen 13 objekte që mbajnë statusin monument kulture të kategorisë së parë: ansambli i rrugës "Justin Godart", rruga e Hebrenjve, godina e bashkisë së qytetit, Kulla e Sahatit, etj. (Figura 37). Objektet monument kulture janë ndërtesa me lartësi deri në tre kate, të ndërtuara kryesisht në fillim të shekullit të 20të. Përveç monumenteve të kulturës në zonë ka edhe objekte të tjerë që nuk mbajnë këtë status mbrojtjeje, por që i përkasin të njëjtës periudhë ndërtimi dhe që mbartin vlera arkitektonike të periudhes së ndërtimit.

Ndërhyrjet e lejuara në Ansamblin Arkitekturor

Sipas ligjit Nr. 9048 date 07/04/2003 “Per Trashegimine Kulturore” dhe akteve të tjera nenligjore, me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Ansambilit, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

- Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese e të bimësisë tradicionale.
- Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Ansambilit.
- Ndërhyrjet rehabilituese në shumë ndërtime në gjendje rrënoje konservuese ose restaurimet integruese për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstrukcioni në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3 m, ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen, duke zbatuar parimet e mësipërme.

Ndërhyrjet e propozuara në kuadër të këtij projekti (përshtatjet, rikonstrukcionet e restaurimet) janë në përputhje të plotë me tipologjinë e ndërhyrjeve të lejuara të përmendura më lart.

Popullsia

Transformimet politike e social-ekonomike të Shqipërisë që nga viti 1990 reflektohen në tendencat demografike të vendit: (i) migrim masiv urban, kryesisht drejt qyteteve më të mëdha; (ii) emigracion shumë i lartë, kryesisht i meshkujve në kërkim të punësimit në vende të tjera; dhe (iii) rënie e shpejtë e numrit të lindjeve. Keto tendenca kane ndikuar dhe ndikojne edhe ne demografine e Vlorës.

Censusi i fundit i vitit 2011 shënon një popullsi rezidente në Bashkinë Vlorë prej 104,827 banorësh me një rënie prej 6,549 banoresh ne krahasim me vitin 2001, ose rreth 6% te popullsisë. Kjo rënie është megjithatë më e vogël se renia e popullsisë së Shqipërisë nga viti 20114 ne vitin 2001 që është rreth 8%. Po të shihen të dhënat e ndryshimeve sipas njësive të vjetra administrative vihet re se pjesa urbane e Bashkisë Vlorë, që perfaqesohet nga Bashkia e vjetër Vlorë, ka pësuar një rritje të popullsisë për 5990 banorë në vitin 2001 nëkrahasim me 1989 dhe 1861 banorë në vitin 2011, në krahasim me 10 vitet e para, duke kompensuar ne nje fare mënyre ndryshimet negative të popullsisë në të gjitha njësitet e tjera administrative që përbejnë Bashkinë Vlorë, si Orikumi qe shenon 5503 banore rezident në krahasim me 8565 ne vitin 1989. Po kështu, nje rënie të ndjeshme e popullsisë rezidente shënohet edhe në njësitet e tjera adminsitratve si ish Komuna Qendër, Novoselë dhe Shushicë.

Bashkia Vlorë ka në total një shpërndarje pothuajse të barabartë meshkuj-femra të popullsisë rezidente, gjë që tregon se flukset migratore tashmë janë stabilizuar duke eliminuar shpërndarjen jo të regullt në popullsi sipas gjinisë. Të njëjtën rregullsi të shperndarjes kanë edhe njësitet administrative të Bashkisë Vlorë.

Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 629 km². Duke marrë të dhënat e censusit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 167 banorë për km². dendesia më e madhe e popullsisë në Bashkinë Vlorë është në qytetin e Vlorës, në të cilën jetojnë 2650 banorë për një km². Ndërsa në territorin e njësive administrative Qendër, e cila rrethon pjesën urbane të qytetit të Vlorës jetojnë rreth 91 banorë për km². Në ndyshim me njësinë administrative Qëndër, kemi njësitet administrative Novesele dhe Shushice në të cilat jetojnë respektivisht 60 dhe 61 banorë për km². Territori i Orikumit rezulton të ketë dendesinë më të vogël në Bashkinë Vlorë me 18 banorë për km².

Ekonomia dhe Punesimi

Zhvillimi ekonomik në territorin e Bashkisë Vlorë ka mundësi dhe potenciale të jashtëzakonshme në drejtim të zhvillimit ekonomik, në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Gjiri i Vlorës është përdorur dhe vazhdon të përdoret edhe sot si një vend me mundësi të mira për ankorimin e anijeve të tipeve të ndryshme. Porti i Vlorës është porti më i madh i Shqipërisë Jugore dhe i shërben të gjithë rajonit përreth, në transportin e mallrave dhe udhëtarëve.

Në nivel kombëtar, në vitin 2014, ndërmarrjet aktive në Bashkinë Vlorë zenë 5.3 % të ndërmarrjeve aktive, nga 5.1% që zinin në vitin 2013. Po kështu rritje të peshes specifike të ndërmarrjeve aktive ka edhe në nivel qarku, ku në vitin 2014 arrihet në 62% nga 60.8 % për vitin 2013, gjë që tregon se përgjithësisht rajoni i Bashkisë Vlorë po merr përparësi në drejtim të

zhvillimit të biznesit. Pjesa e madhe e këtyre ndërmarrjeve ndodhen në ish bashkinë e vjetër Vlorë. Në vitin 2014 numërohen 4,917 ndërmarrje aktive nga 5,917 të tilla për gjithë Bashkinë, ose 82.7% të ndërmarrjeve aktive.

Numri më i madh i ndërmarrjeve ekonomike ndodhen në sektorin e tregtisë me 2,202 njësi ose 37.1% të ndërmarrjeve aktive. Në vend të dytë me 19.3% nga pikëpamja e numrit, radhiten sektori i hotelierisë dhe restoranteve (akomodimi dhe shërbim ushqimor) me 1,143 ndërmarrje aktive dhe sektori i industrisë përpunuese dhe transporti me 8.2 dhe 7.8 % të totalit të ndërmarrjeve.

Nga numri total i ndërmarrjeve aktive, i barazvlefshëm me 5.937 në Bashkinë Vlore, 78.7% e tyre janë organizuar si person fizik (PF) dhe 21.3% dhe 1.264 ndërmarrje aktive janë në një prej formave të tjera të shoqërive tregtare. Kjo situatë flet përgjithësisht për një organizim jo të mirë të ndërmarrjeve aktive, pasi forma si PF nuk i lejon këtyre ndërmarrjeve të kenë akses shumë të madh në tregun financiar. Mungesa e aksesueshmërisë i referohet si kredimarrjes afatgjata, ashtu edhe krijimit të formave dhe sinergjive për tërheqjen e kapitaleve pranë këtyre ndërmarrjeve, në formën e kapitalit aksionar apo pjesmarrjen në shoqëri.

Nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Vlorë, përqindja më e lartë e punësimit është në Bashkinë Vlorë me 67.5 %, e cila tejkalon edhe nivelin kombëtar prej 54.5 % të popullsisë. Njësitë e tjera administrative kanë një nivel punësimi shumë të ulët gjë që flet për diferenca mjaft të mëdhe sociale.

IV. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR

Qëllimi i Projektit

Zona për të cilën hartohet projekti është zona ku qyteti i Vlorës ruan ende gjurmë të ndërtimeve të fundshekullit të 19-të dhe fillim shekullit të 20-të. Pothuaj e gjithë zona përfshihet brenda kufijve të zonës arkeologjike të qytetit, "A" ose "B". Brenda kufijve të zonës së projektit ndodhen disa monumente kulturore të kategorisë së parë si edhe rruga më e rëndësishme e qytetit për nga vlerat arkitektonike-historike që mbart; rruga “Justin Godard”. Ky segment që prej vitit 1980 gëzon statusin e monumentit të kulturës të kategorisë së parë

Qëllimi kryesor i projektit është: Restaurimi i monumenteve të kulturës dhe rikualifikimi urban i zonës së studimit, në mënyrë që nëpërmjet restaurimit, konservimit dhe rehabilitimit të vendbanimeve tradicionale dhe i zonave të trashëgimisë kulturore të rritet turizmi dhe si rrjedhojë zhvillimi ekonomik i zonës.

Pershkrimi i projektit

Termet e Referencës:

Qëllimi kryesor i projektit është: Restaurimi i monumenteve të kulturës dhe rikualifikimi urban i zonës së studimit, në mënyrë që nëpërmjet restaurimit, konservimit dhe rehabilitimit të vendbanimeve tradicionale dhe i zonave të trashëgimisë kulturore të rritet turizmi dhe si rrjedhojë zhvillimi ekonomik i zonës.

Nderhyrjet kryesore të propozuara do të jenë :

Rikualifikimi i shesheve;

Rikonstruksioni i rrugës “Perlat Rexhepi” dhe trotuareve;

Rikonstruksioni i godinave; AO36 / AN24 / AN03 / BN 46 / BN 44

Rikualifikimi i dy shesheve publike (sheshi i kullës së sahatit dhe sheshi “4 heronjtë”);





Planvendosja e strukture se objektit

Përshkrimi i proceseve teknologjike të ndertimit te objektit

Në zonën e projektit ndodhen disa objekte që mbajnë statusin monument kulture të kategorisë së parë: godina e bashkisë së qytetit, Kulla e Sahatit, etj. Objektet monument kulture janë të ndërtesa me lartësi deri në tre kate, të ndërtuara kryesisht në fillim të shekullit të 20të. Përveç monumenteve të kulturës në zonë ka edhe objekte të tjerë që nuk mbajnë këtë status mbrojtjeje, por që i përkasin të njëjtës periudhë ndërtimi dhe që mbartin vlera arkitektonike të periudhës së tyre të ndërtimit. Bazuar në periudhën e ndërtimit objektet janë klasifikuar në tre grupe kryesore, ndarje kjo e cila kushtëzon dhe orienton mënyrën e ndërhyrjes në çdo objekt. Klasifikimi është bërë si vijon: objekte të ndërtuar para dhe gjatë luftës së dytë botërore që janë kryesisht objekte me lartësi deri në tre kate; objekte të ndërtuar gjatë viteve '45-'90, kryesisht objekte me lartësi deri në pesë katë; objekte të ndërtuar pas viteve '90, lartësia e të cilëve varion nga një deri në dymbëdhjetë kate. Funkzioni i ndërtesave në të gjithë zonën është gjithashtu i shumëllojshëm megjithatë në katet përdhe dominon funksioni tregtar dhe në katet e sipërme objektet kanë funksion banim.

Zona paraqet probleme të shumta, por në *mënyrë të përmbledhur problematikat më shqetësuese që hasen në të gjithë zonën në studim janë:*

- *Deformimi i shkallës urbane.* Ndërtimet e pas viteve '90, të cilat ishin krejtësisht eklektike për sa i përket gjuhës arkitektonike dhe lartësisë së tyre kanë tjetërsuar shkallën urbane në këtë zonë. Deri në vitet '90, zona ka pasur një homogjenitet të lexueshëm si në lartësi të objekteve, në mënyrën e mbulimit të tyre, mënyrën e trajtimit arkitektonik. Lartësia e objekteve jo më e madhe se 5-6 kate krijonte me rrugët dhe sheshet një raport më të pranë shkallës njerëzore.
- *Mungesa e hapësirave publike.* Ndërtimet pa kriter pas viteve '90, kanë zënë hapësirat ndërmjet objekteve që kanë qenë të lira deri në atë kohë. Këta sheshe janë kthyer në zonë tranzitore, në parkime rastësorë automjeteve ose kanë ngushtuar gjerësinë e trotuarëve dhe

zonave këmbësore. Ato pak hapësira të lira të mbetura shfrytëzohen ose prej bareve në zonë për vendosjen e tavolinave, ose prej shitësve ambulantë, ose prej dyqaneve të fruta perimeve që nxjerrin tezgat me produktet që tregtojnë.

- *Qarkullimi jo i zgjidhur i automjeteve.* Rruga "Perlat Rexhepi" është edhe e vetmja rrugë që të lidh me spitalin. Si e tillë, ka nevojë që të ketë një korsi emergjence për kalimin e autoambulancave. Krijimi i rreth rrotullimit në sheshin përpara bashkisë së qytetit, intensifikon trafikun në këtë zonë duke i detyruar automjetet që vijnë nga spitali të bëjnë rreth rrotullimin. Përdorimi i shumë hapësirave në sheshe për parkim automjesh. Edhe vetë gjendja e infrastrukturës rrugore (shtresat e rrugëve dhe rrugicave) paraqet degradime të shumta; mungesë uniformiteti në mënyrën e shtrimit të rrugëve ku në disa segmente është e shtruar me kalldrëm e në disa të tjerë është e shtruar me asfalt.

- **Lëndët e para**

Lendet e para te perdorura jane kryesisht betonit i cili blihet i gatshem nga firmat e prodhimit te betonit ne zone, hekuri per strukturen e objektit etj.

- **Ndikimet pozitive**

Ndikimet potenciale pozitive që pritet të lidhen me zbatimin e projektit përfshijnë si në vijim:

- **Rritje e numrit të turistëve**

Vlora tërheq disa dhjetra mije vizitorë në vit për shkak të natyrës dhe bregdetit të saj të mrekullueshëm, trashëgimise kulturore dhe të vendeve arkeologjike të njohura ndërkombëtarisht. Ky numër pritet të rritet me shpejtësi me zbatimin e projektit. Për më tepër, do të ketë potencial për të integruar Ansamblin historik në një rrjet më të gjerë të itinerareve turistike duke e përfshirë si pjesë e turizmit të trashëgimise kulturore.

- **Permireshimi i vleres së pronës**

Aktiviteti i propozuar do të ketë ndonjë ndikim të madh vizual mbi estetikën e lokacionit duke e përmirësuar thelbësisht atë. Pas nderhyrjeve në objekte që do restaurohen apo rikonstruktohen, projekti do të ndikojë pozitivisht në rritjen e vlerës së pronave të qytetarëve, banorë të Ansamblit historik të Vlorës.

Masat përmisuese: Fasadat e jashtme të ndërtesave të lyhen në një ngjyrë që përshtatet me mjedisin ekzistues

- **Mundësitë për punësim**

Nderhyrjet restauruese/rikonstruktuese do ta bëjnë zone edhe me atraktive për biznese të ndryshme, kryesisht shërbime. Këto do të krijojnë mundësi të tjera për punësim afatgjatë për profesioniste të ndryshme por edhe për punonjës jo shumë të kualifikuar, përfshirë edhe gratë që mund të rikthehen traditës së punimeve artizanesh sidomos për prodhime për turistët.

Masat përmirësuese: Kur është e mundur duhet të konsiderohet punësimi i njerëzve të kualifikuar nga banorët lokalë.

▪ **Rritje e eficiencës energjitike**

Ruajtja e trashëgimisë zvogëlon përdorimin e energjisë dhe emetimet e gazrave serrë. Energjia e përdorur për të nxjerrë, prodhuar, transportuar dhe instaluar materialet e nevojshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një ndërtese quhet "energji e mishëruar". Energjia e mishëruar në një ndërtesë mesatare komerciale është ekuivalente me 1.0 deri në 4.0 Litra benzinë/m². Kur një ndërtesë prishet, energjia e saj e mishëruar humbet. Edhe nëse një ndërtesë zëvendësuese është me efikasë në energji, do të duhen dekada para se kursimet në energji gjatë funksionimit të jenë më të mëdha se energjia e mishëruar e ndërtesës së vjetër, energjia e përdorur në prishjen dhe energjia e nevojshme për ndërtimin e ri. Nëse struktura dhe karabinaja e një ndërtese ripërdoren, gjysma e energjisë së saj të mishëruar ruhet.

Masat përmirësuese: Nuk ka.

▪ **Ndikimet negative**

Ndikimet negative gjatë funksionimit të projektit mund të lindin nga:

- a) Menaxhimi i papershtatshem i mbetjeve (përfshirë mbetjet urbane dhe shkarkimin e ujërave të zeza);
- b) Mungesa e mirëmbajtjes, që mund të cojë objektet e restaurura/rikonstruktura drejt degradimit ose prishjes; dhe
- c) Rreziku i shpërthimit të zjarreve

Keto ceshtje janë diskutuar në seksionet në vijim.

▪ **Menaxhimi i papershtatshem i mbetjeve**

Si rezultat i rigjallërimit të këtij Ansambli historik pritet të gjenerohen mbeturinat e ndryshme. Keto mbetje do të jenë të brendshme (shtëpiake) të pa rrezikshme. Trajtimi dhe asgjësimi papershtatshem i këtyre mbeturinave mund të shkaktojë rreziqe për shëndetin publik për shkak të ndotjes së mjedisit: ndotjejt e ajrit, ndotje të rrjedhave të ujit dhe infeksione në rastet kur njerëzit apo fëmijët kërkojnë përmes mbeturinave të ndryshme.

Ndikimi do të jetë *afat-gjatë* që mund të zgjasi gjatë gjithë jetëgjatësisë së kompleksit. Intensiteti i ndikimit është i ulët nëse Bashkia dhe komuniteti marrin masat e nevojshme për trajtimin e tyre. Ndeshmëria mbi receptorët do të jetë *e ulët*, duke i dhënë një rëndësi të vogël ndikimit.

▪ **Strategjitë zbutëse që duhet të ndërmerren:**

- 1) Masa kryesore për të zbutur ndikimet është parandalimi i cili përfshin identifikimin e llojeve të mbetjeve dhe ndarjen e tyre që në burim.
- 2) Ndergjegjesimi i komunitetit për domosodshmerinë e ndarjes së mbetjeve që në burim.

▪ **Degradimi i ndërtesave nga mungesa e mirëmbajtjes**

Ndertesat qe do restaurohen/rikonstruktohen do te kene nevojë vazhdimisht per mirembajtje. Mungesa e kujdesit dhe mirembajtjes do te sillte degradim te tyre, humbje ne eficencen energjitike dhe prodhim te materialeve inerte.

Ndikimi do te jete *afat-gjatë* që mund te zgjasi gjithë jetëgjatesise ne rast mungese mirembajtje ose *afat-shkurtër* në varësi të nivelit te kujdesit qe do te tregohen per mirembajtjen e ndertesave. Intensiteti i ndikimit është i ulët sikurse edhe ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë *e ulët*, duke i dhënë një rëndësi të vogël ndikimit.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë i ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	I ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë zbutëse që duhet të ndërmerren:

- Masa kryesore për të zbutur ndikimet është perkujdesja ndaj objekteve dhe zyrtarizimi i masave pro-aktive për të shmangur demtimet ne struktura apo arkitekturen e ndertesave brenda Ansamblit.

Rreziku i shperthimit te zjarrit

Ne mungese te masave te sigurise ndaj zjarrit, ekziston rreziku i zjarreve me pasoja katastrofike per jeten dhe ndikim te madh financiar. Zjarret mund të fillojnë nga materiale të ndezshme në shtëpi, pirja e duhanit në vende jo të caktuara apo lidhjet elektrike.

Gjasat qe ky ndikim te ndodhi dhe intensiteti i saj janë të *Ulëta*, pasi zona ka nje projekt te mire dizenuar qe ka marre ne konsiderate edhe keto aspekte. Megjithatë, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë *Mesatare*, duke i dhënë një rëndësi të *Moderuar* te ndikimit.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët 1	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët 2	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare 3	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë 4	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Paisjet për shuarjen e zjarrit do të vendosen në vende strategjike brenda zones dhe do të merren masa që të gjitha pajisjet zjarrfikëse janë mirembajtur rregullisht dhe janë në gjendje shërbimi.
- Numrat e telefonit të repartit zjarrfikës të qytetit duhet të vendosen në të gjithë vende të dukshme.
- Një sistem alarmi automatik kundër zjarrit duhet të instalohet në të gjithë objektet që gëzojnë statusin e monumenteve të kultures së kategorisë së parë.

V.PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet rëndësishme në mjedis gjatë ndërtimit.

Në këtë kapitull, parashikohen dhe analizohen ndikimet e mundshme pozitive dhe negative gjatë ndërhyrjeve restauruese që do të aplikohen në objektet monument kulture në ansambin e rrugës, ndërhyrjeve rikonstruktuese të cilat do të aplikohen në të gjithë objektet e tjerë në zonën e projektit dhe ndërhyrjeve unifikuese që konsistojnë në unifikimin e elementëve të fasadave (në objektet që nuk janë monument kulture), apo shembja e stukturave eksistuese apo elementeve strukturore dhe jo-strukturore që cenojnë integritetin lokal të ndërtësive në zonë. Duke qenë se vendi i projektit është brenda një zone të banuar tashmë prej disa dekadash, shumica e ndikimeve social-mjedisore të lidhura me këtë projekt do të jenë të drejtpërdrejta në natyrë dhe kryesisht rezultojnë nga aktivitetet e ndërtimit. Analiza e ndikimit do të përfshijë përcaktimin e madhësisë, masës, kohëzgjatjes dhe rëndësinë e ndikimeve të mundshme. Në seksionet e mëposhtme është paraqitur një vlerësim i detajuar i ndikimeve të pritshme.

VI. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE

Punimet ndertimore, duke ju referuar grafikut te punimeve qe shoqeron dokumentacionin e projektit rezulton se kohezgjatja e punimeve mund te zgjasin per nje periudhe prej ____ mujore. Kjo eshte koha normale qe duhet per te perfunduar se ndertuari kete objekt ne kushte normale. Kjo eshte e vlefshme ne kushte teknike, juridike e klime normale, por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve mund te kete edhe shtyrje te afatit.

Si rrjedhoje edhe ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per ndertimin e magazines. Funksionimi i projektit te propozuar mendojme se mund te realizohet menjeher me perfundimin e punimeve konform legjislacionit ne fuqi per planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe lejes mjedisore.

Gjithashtu, si faktor vleresohet edhe numri i popullsisë qe do te frekuentoje kete zone e cila ka si qellim sherbimet. Keto ndikime nuk jane me rendesi te vecante, keto jane te krahasueshme me cdo objekt tjeter sherbimesh qe ndodhet ne zonen e Fierit. Te gjitha ndikimet e mesiperme nuk jane te perhershme dhe afatgjata, ato jane te perkohshme dhe afatshkurter. Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e ndertimit dhe i perhershem nga zenia e hapësirës.

VII. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Përshkrimi i ndikimeve

Përshkrimi i një ndikimi të mundshëm përfshin një vlerësim të karakteristikave të tij, së bashku me atributet e mjedisit pritës. Karakteristikat perkatese të ndikimit përfshijne nëse ndikimi është:

- Negativ apo i dobishëm;
- I drejtpërdrejtë ose i tërthortë;
- Afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë në kohëzgjatje; dhe i përhershëm ose i perkohshëm;
- Me ndikim në shkallë lokale, rajonale ose globale; përfshirë edhe ndikimin ndërkuftar; dhe
- Kumulative (Një ndikim kumulativ është "ndikimi në mjedis që rezulton nga rritja e ndikimit te një veprimi, kur shtohet mbi veprime të tjera te ndodhura ne të kaluarën, tashmen apo dhe të veprimeve të arsyeshme të parashikuara te ndodhin ne të ardhmen").

Secila nga këto karakteristika eshte diskutuar për çdo ndikim. Marrja në konsideratë e treguesve te mësipërm jep një ndjenjë të intensitetit relativ të ndikimit. Ndjeshmëria e mjedisit pritës u përcaktua nga specialistët bazuar në të dhënat bazë të mbledhura gjatë studimit.

Vlerësimi i ndikimit

Çdo ndikim është vlerësuar duke përdorur kriteret e renditura në Tabelë. Për të siguruar një ilustrim relativ shkalles së ndikimit, është e dobishme që të caktohen përshkrues numerike ose relativë të intensitetit të ndikimit dhe ndjeshmëria e receptorit për çdo ndikim të mundshëm. Secili kriter është vlerësuar ne një shkallëzim numerik 1, 2, 3, ose 4, që korrespondon me nivelet:

shumë të ulët, të ulët, të mesëm ose të lartë. Shkalla (ashpërsia) e ndikimit është llogaritur më pas si produkti i dy përshkruesve numerike, duke e përshkruar shkallen (ashpërsine) e ndikimit si të papërfillshme, të vogël, të moderuar apo të madhe, siç është ilustruar në Tabelën 9. Kjo është një metodë cilësore e projektuar për të siguruar një renditje të gjerë të ndikimeve të ndryshme të një projekti. Në Tabelë janë dhënë ilustrime të llojeve të ndikimit që marrin vlera të ndryshme të ashpërsisë.

Tabela. Klasifikimi i vleresimit të ndikimeve në mjedis

	Klasifikimi	Përshkrimi
1	Shtrirja:	Vlerësimi i zonës së shfaqjes/influences të ndikimit mbi mjedisin në fjale; nëse ndikimi do të ndodhë në vend, në një zonë të kufizuar (brenda një rrezeje prej 2 km nga vendi i projektit); në nivel lokal (brenda një rrezeje prej 5 km); rajonal (nivel qarku, kombëtar ose ndërkombëtar).
2	Vazhdimësia/ Kohezgjatja:	Vlerësimi i kohëzgjatjes së ndikimit në mjedis, nëse ndikimi ka qenë i përkohshëm (<1 vit); afat-shkurtër (1 - 5 vjet); afat-mesëm (5 - 10 vjet); afatgjatë (> 10); ose i përhershëm.
3	Konteksti social / Ndjeshmeria ose Potenciali për konflikt ndërmjet aktorëve:	Vlerësimi i ndikimeve për receptorët e ndjeshëm në aspektin e ndjeshmërisë ekologjike, sociale dhe aspekteve të tilla si specie të rralla dhe të rrezikuara, mjedise sensitive ekologjike dhe të rrezikuara, arkitekturë, mjedis shoqëror ose kulturor, potencial i madh për konflikte interesash të aktoreve të ndryshëm. Klasifikimi i ndjeshmërisë është paraqitur më poshtë: <i>Ndjeshmëri e lartë:</i> Zhvendosje e gjithë komunitetit, shkatërrim i trashëgimisë botërore apo vendeve të rëndësishme kulturore, konflikt në shkallë të madhe të grupeve të interesit, etj <i>Ndjeshmëri Mesatare:</i> Zhvendosja e disa familjeve, niveli i moderuar i shqetësimit të palëve të interesuara <i>Ndjeshmëri e ulët:</i> Nuk janë të nevojshme zhvendosjet, nuk ka potencial për konflikt të palëve të interesuara.
4	Pajtueshmëria me kerkesat ligjore dhe kuadrin rregullator	Vlerësimi i ndikimit ndaj kërkesave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>E lartë:</i> Shkelje të mëdha të kërkesave rregullative që mund të rezultojnë në ndjekje penale ose vonesa të mëdha në miratimin e projektit. <i>Mesatare:</i> Shkelje potenciale të kufijve specifike të kuadrit rregullator që mund të rezultojnë në mospërputhje. <i>E ulët:</i> Nuk parashikohen shkelje të kufijve të veçantë të kuadrit rregullator.
5	Vlerësimi i Ndikimit në përgjithësi (Rendësia):	Duke përdorur një kombinim të kriterëve të mësipërme, rëndësia e përgjithshme e ndikimit është kategorizuar si: shumë e madhe, thelbësore, e moderuar, e vogël dhe e papërfillshme. Referojuni Tabelës 10 për kategoritë specifike të ndikimit për secilin vlerësim.

Shënim: Këto janë vetëm udhëzime që do të përbëjnë gjykimin profesional që kërkohet në çdo rast individual.

Rendesia e ndikimit

Rëndësia e ndikimit është përcaktuar nepërmjet nje matrice të rëndësise se ndikimit e cila krahason peshën e ndikimit me probabilitetin e ndodhjes së tij. Kriteret e rëndësisë se ndikimit janë si më poshtë:

- *Shumë i Lartë (VH) dhe i lartë (H):* Këto tregojne se ndikimi është i papranueshëm dhe se duhet të zbatohen masa të tjera zbutëse për të zvogëluar rëndësinë. E ngjyrosur me ngjyrë të kuqe në Tabelën 10.
- *Mesatare (M):* Ndikimet në këtë rajon konsiderohen të tolerueshme por duhet të bëhen përpjekje për të reduktuar ndikimin në nivele që janë aq të ulëta sa gjykohen si praktikisht të arsyeshme. E ngjyrosur me ngjyrë të verdhë në matricën e rëndësisë së ndikimit.
- *E ulët (L):* Ndikimet në këtë rajon janë konsideruar të pranueshme. E ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër.

Tabela. Përcaktimi i rendesise se ndikimit

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët	E ulët	Mesatare	E lartë
			1	2	3	4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Ndikimi kumulativ

Efektet kumulative vihen re kur kushtet socio-mjedisore janë tashmë ndikuar nga zhvillimet e kaluara ose me shumë të ngjarë do të ndikohen nga zhvillime apo aktivitete qe është e mundshme të zhvillohen në të ardhmen. Në këtë VNM janë identifikuar aktivitete të së kaluarës, aktuale, dhe aktivitete të ngjashme që është e mundshme të ndodhin në të ardhmen dhe që mund të komplikojnë kushtet socio-mjedisore në zonën e projektit.

Zbutja e ndikimeve ne mjedis

Masat zbutëse janë planifikuar për të shmangur, reduktuar, zbutur apo kompensuar ndikimet negative mjedisore dhe sociale dhe janë pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM).

VIII. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME

Subjekti nepermjet firmes ndertuese te kontraktuar, duhet qe pas perfundimit te ndertimit te objektit dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, si ato te shtruara me beton ose pllaka, per rruget hyrese, sheshe parkimi dhe per siperfaqet e gjelberta. Duhet te mbillen peme ne perimetrin e zones per te reduktuar ndikimin ne peizazh, si dhe brenda mundesive te mbillen bimet qe i rezistojne ketyre kushteve klimaterike, pra bime autoktone. Per kete te konsultohen me specialistet perkates. Siperfaqja e lire e prones te shnderrohet ne nje mjedis te gjelbert, te paster dhe te sigurte ndaj faktoreve te ndryshem.

IX. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Ndikimet Pozitive

Zhvillimi i projektit nënkupton punimet civile që kërkojnë materiale të tilla si zhavorr, tulla, lëndë druri, hekur dhe çimento. Ky ndikim është pozitiv, por afatshkurtër dhe ndikimi i kthyeshëm. Duke pasur parasysh se puna ndërtimore do të jetë lokale apo kombëtare, ky ndikim ka shtrirje lokale apo kombëtare.

Masat përmirësuese: Lendet e para (materialet e ndertimit) duhet të merren vetëm nga subjekte të licensuara. Materialet e ndertimit të cilat do të përdoren për konsolidimin e objekteve, do të jenë në përputhje me specifikimet teknike europiane. Blerja e vetëdijshme ose i paqëllimtë e këtyre materialeve nga operatorë të palicencuar në mënyrë indirekte nxit degradimin e mjedisit në zonat ku janë vendosur këto subjekte të paligjshme dhe mund të shpjerë në ndikime negative afatmesme apo afatgjata. Prandaj, blerja e materialeve të ndertimit nga guroret e licencuara dhe që operojnë në mënyrë legjitime duhet të jetë një detyrim kontraktual për kontraktorët.

Ndikimet negative

Menaxhim jo i përshtatshëm i mbetjeve nga shembja e stukturave ekzistuese apo elementeve strukturore ose jo-strukturore që çenojnë integritetin lokal të ndërtesave.

Identifikimi i ndikimit: Ndërhyrjet restauruese që do të aplikohen ne objektet monument kulture, ndërhyrjet rikonstruktuese të cilat do të aplikohen në të gjithë objektet e tjerë në zonën e projektit, ndërhyrjet unifikuese që konsistojnë në unifikimin e elementëve të fasadave (në objektet që nuk janë monument kulture), apo shembja e stukturave ekzistuese apo elementeve strukturore dhe jo-strukturore që çenojnë integritetin lokal të ndërtesave janë aktivitete që mund të gjenerojnë mbeturina të konsiderueshme të përbërë nga tulla, blloqe betoni, metale, qelq dhe mbeturinave druri. Duke pasur parasysh se këto objekte janë mbi 40-50 vjeçare, nuk mund të përjashtohet edhe prania e plumbit në bojën e përdorur për të lyer këto mure që do të rrëzohen.

Vlerësimi i ndikimit: Trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndertimit mund të ketë ndikime në mjedis dhe shëndetin publik. Hidrologjia e ujërave sipërfaqesore mund të preken gjatë prishjes

nëpërmjet gërryerje se materialeve të imta të gjeneruara si rezultat i pastrimit të mbetjeve dhe sipërfaqes të tokës të ekspozuar ndaj shiut dhe kullimit të ujërave. Keto mund të depozitohen në rrjedhat e ujit dhe ndryshojnë natyrën e shtratit të përrrenjve.

Rëndësia e ndikimit: largimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit mund të ketë ndikime afatmesme apo afatgjatë në mjedis dhe shëndetin publik. Shtrirja e këtij ndikimi do të jetë lokale në zonat ku do të hidhen mbetjet, apo në lagjet në afërsi. Mundësia që ky ndikim të ndodhi është *E lartë* duke patur parasysh mungesën e objekteve që trajtojnë mbetjet e ndërtimit. Nëse hidhen në vende të papërshtatshme mbetjet e ndërtimit ndotin burimet mjedisore (tokën dhe ujin) apo shkaktojnë efekte në shëndetin publik, ndaj edhe rëndësia e këtij ndikimi do të jetë *E moderuar*.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Kontraktoret duhet të bëjë ndarjen e mbetjeve në burim për të ndarë mbetjet e rrezikshme nga ato të pa rrezikshme
- Studim i plotë dhe i detajuar i historikut të vendit të zgjedhur për projektin për të identifikuar rreziqet e mundshme për punëtorët dhe mjedisin;
- Përdorimi i teknikave për të minimizuar ngjeshjen e tokës, të tilla si kufizimin e qasjes gjatë kushte të lagështires, dhe përdorimi i makinerive që ushtrojnë tryzni të ulët në terren;
- Përdorimi i strategjive për kontrollin e pluhurave;
- Percaktimi i rrugës dhe kohës së qarkullimit të kamionëve të rëndë që transportojnë mbeturinat nga shembja e godinave në mënyrë që të shmangen zonat e banuara ose receptorë të tjerë të ndjeshëm njerëzorë sa më shumë të jetë e mundur
- Të ofrohet siguria e duhur për sheshin

- Mbetjet duhet të largohen nga zona e projektit të paktën një herë në 24 orë dhe kur mbahen përkohësisht në vend duhet të mbulohen për të minimizuar aromat e pakëndshme dhe parazitët.
- Kontraktori do të punojë së bashku me Bashkinë për të lehtësuar trajtimin e duhur dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi. Të gjitha mbetjet duhet të hidhen në deponitë e miratuara.
- Mbeturinat e rrezikshme të tilla si bojerat, çimento, adhezivët do të menaxhohen përmes një pale të tretë (kontraktor) të certifikuar nga AKM-ja. Kontraktori do të punojë për të lehtësuar trajtimin e sigurtë dhe asgjësimin e mbeturinave nga sheshi.
- Inxhinierët mbikëqyres (supervizori) dhe inspektorët e agjensisë rajonale të mjedisore duhet të sigurohen se kontraktuesit nuk i hedhin mbetjet në mënyrë të paligjshme në zonat të tjera jashtë atyre të caktuara. Inspektorët e mjedisit nga ARM duhet të ndërmarrin rolin aktiv për monitorimin gjatë periudhës së ndërtimit.
- Duhet të krijohet dhe të zbatohet mekanizmi i ankesave për të adresuar shqetësimet dhe ankesat mundshme nga komuniteti (Seksioni 7.2).

Gjenerimi i mbetjeve (Menaxhim jo i përshtatshëm i mbetjeve të ndërtimit)

Si gjatë fazës së përgatitjes së kantierit ashtu edhe fazës të ndërhyrjeve priten që në shesh të gjenerohen mbetje të ngurta (inerte). Mbetjet mund të përbëhen ndër të tjera nga copa druri apo prerje metalike, materiale të ndryshme plastike, thase letre/ çimento, kuti bosh boje dhe tretësish, xhama të thyer. Disa nga materialet e mbetjeve si bojerat, çimento, adhezivët dhe tretësit për pastrim përmbajnë lëndë të rrezikshme, ndërsa disa nga materialet e mbetjeve përfshirë copat e metalit apo dhe plastike nuk janë të biodegradueshme dhe mund të kenë efekte *afat-gjatë* dhe *kumulative* në mjedis. Keto ndikojnë në mjedis nëpërmjet bllokimit të sistemeve të kullimit dhe njëkohësisht kanë ndikime negative në shëndetin e njeriut. Mbetje të tjera të cilat mund të krijohen nga aktivitetet jo-ndërtimore për shkak të pranisë së punëtorëve në zonën e ndërtimit dhe keto përfshijnë mbetjet ushqimore, ujin e ndotur nga larja dhe pastrimi i pajisjeve apo mjeteve të ndërtimit.

Hedhja pa kriter e mbetjeve të ndërtimit ose derdhja e lëngjeve mund të ketë ndikime afat-mesme apo afatgjatë për mjedisin apo për shëndetin publik. Shtrirja e këtij ndikimi do të jetë lokale në zonat ku do të hidhen mbetjet, apo në lagjet në afërsi.

Mundësia që ky ndikim të ndodhi është *E lartë* duke patur parasysh mungesën e objekteve që trajtojnë mbetjet e ndërtimit. Nëse hidhen në vende të papërshtatshme mbetjet e ndërtimit ndotin burimet mjedisore (tokën dhe ujin) apo shkaktojnë efekte në shëndetin publik, ndaj edhe rëndësia e këtij ndikimi do të jetë *E lartë*. Intensiteti i ndikimit do të jetë *i ulët* dhe duke pasur parasysh se ka resurse minimale ujë në këtë zonë, ndjeshmëria e receptorëve është vlerësuar si *E ulët*. Prandaj rëndësia e ndikimit është *E vogël*.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët	Mesatare 3	E lartë 4
				2		
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Kontraktoret duhet të bëjnë ndarjen e mbetjeve dhe inkurajuar riciklimin e mbetjeve te pershtatshme
- Kontraktoret duhet të bëjnë ndarjen e mbetjeve për të ndarë mbetjet e rrezikshme nga ato të pa rrezikshme
- Mbetjet duhet të merren nga sheshi të paktën një herë në 24 orë dhe kur mbahen përkohësisht në vend duhet të mbulohen për të minimizuar aromat e pakëndshme dhe parazitët.
- Kontraktori dhe Bashkia do të punojnë së bashku për të lehtësuar trajtimin e duhur dhe asgjësimin e mbeturinave nga zona e projektit. Të gjitha mbetjet duhet të hidhen në deponitë e miratuara.
- Mbeturinat e rrezikshme të tilla si bojerat, çimento, adhezivët do të menaxhohen përmes një pale të tretë (kontraktor) të certifikuar nga AKM-ja.

Presioni mbi burimet (lëndët e para) ekzistuese

Gjatë fazës së ndërtimit, kërkesa për lëndet e para baze të tilla si uji dhe energjia elektrike mund të ushtrojë presion mbi infrastrukturën ekzistuese.

Duke pasur parasysh natyrën e projektit, *intensiteti i ndikimit* do të ketë *I ulët* dhe afat-shkurtër dhe i kufizuar vetëm gjatë fazes së ndërtimit. Megjithatë, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë *E lartë*, duke dhënë një ndikim me rëndësi të moderuar.

Rëndësia e ndikimit:

	Ndjeshmeria e receptorit
--	--------------------------

			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktuesi duhet të sigurojë vend (depozite) të veçantë për ujin që do të përdoret në ndërtim. Në vend që të lidhet me sistemin e furnizimit me ujë të zones, kontraktori duhet të zgjedhi të përdore uje nga depozitat per furnizimin me uje.

Gjenerimi i zhurmave

Zhurma do të jetë një nga pasojat më të padëshirueshme të fazës së ndërtimit. Gjatë fazës së ndërtimit në zonë priten të regjistrohen nivele relativisht të larta të zhurmes. Nivele të konsiderueshme të zhurmës dhe vibrimeve pritet të shkaktohen kryesisht nga përdorimi i pajisjeve të rënda, duke përfshirë dhe kamionët që transportojnë mbetjet dhe materialet e ndërtimit gjatë përgatitjes së sheshit dhe veprimtarive të ndërtimit. Edhe pse niveli i shqetësimit të shkaktuar nga zhurmat është subjektiv, ndikimet e raportuara më së shpeshti të rritjes të nivelit të zhurmës janë ndërhyrjet në komunikim dhe shqetësimet gjatë periudhës së gjumit apo gjatë kohës të pushimit. Shqetësimet që rezultojnë nga zhurmat e ndërtimit nuk mund të përjashtohen duke pasur parasysh se zona e projektit është e banuar dhe mjaft e populluar.

Receptorët e ndikimit përfshijnë banoret e zones dhe frekuentuesit e bareve dhe lokaleve në zonën e projektit. *Intensiteti i ndikimit* do të jetë mesatar në qoftë se për të kryer aktivitetet ndërtimore është kontraktuar një kontraktor me përvojë. Megjithatë, *ndjeshmëri mbi receptorët* do të jetë *E lartë* meqë vendi i propozuar është në një zonë të banuar dhe me shumë njësi të tjera shërbimi, prandaj rëndësia e ndikimit konsiderohet *E madhe*.

Rëndësia e ndikimit:

	Ndjeshmeria e receptorit
--	--------------------------

			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Kontraktori do të jetë i kujdesshëm ne zgjedhjen e pajisjeve për të shmangur përdorimin e makinerive të vjetra apo të dëmtuara me nivel të lartë të emetim zhurme që do të kenë një ndikim negativ në mjedis.
- Kontraktori do të sigurojë që pajisjet janë të mire-shërbyera dhe efikase.
- Kontraktori do të bllokojë sheshin e ndërtimit me materiale që zbutin zhurmën, për shembull, përdorimi i kompensatës në vend të fletëve te llamarinave
- Punëtorët e ndërtimit do të jenë në dijeni të natyrës së ndjeshme të vendet të punës brenda të cilit ato operojnë dhe do këshillohen që të kufizojnë zhurmën verbale ose format e tjera të zhurmës. Për shembull, objektet apo mjetet metalike mund të kalojnë nga një koleg tek një tjetër koleg në vend që të hidhen poshte ose të lihen të bien me shumë zhurmë.
- Kontraktori do të sigurojë që nivelet e zhurmës që gjenerohen nga makinerite, automjetet dhe aktivitetet e zhurmshme të ndërtimit mbahet në nivele minimale për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e njerëzve në ndërtesat e afërta.
- Zhurma dhe vibrimet në vendin e projektit dhe zonat përreth do të minimizohen nepermjet sensibilizimit te shoferëve të kamioneve te ndërtimit për të fikur motorët e automjeteve, gjatë shkarkimit te materialeve.
- Të gjithë gjeneratorët dhe pajisjet e rënda gjeneruese të zhurmave do të izoloohen ose të vendoson në rrethina për të minimizuar rritjen e zhurmës mbi nivelin e zakonshme te ambientit

Trafiku dhe emetimet e lidhura me të

Emetimet e lindura nga trafiku përfshijnë pluhurin dhe tymrat. Emetimet e pluhurit do të dalin nga aktivitetet e ndërtimit (nderhyrjet restauruese dhe rikonstruktuese) dhe trafiku i mjeteve të ndërtimit. Kamionët e përdorur për të transportuar materiale të ndryshme ndërtimi nga burimi i tyre për në sheshin e ndertimit të objektit emetojnë gazra te ndryshem si SO₂, CO₂, CO, NO_x dhe grimca. Ndikimet e emetimeve të tilla mund të jenë më të medha në vendin e ndërtimit dhe

në komunitetet ndermjet te cilave do të udhëtojnë automjetet e ndërtimit. Receptorët e ndikimit përfshijnë komunitetet përgjatë rrugëve te transportit, dyqanet dhe tregjet anës rrugëve, punëtorët e ndërtimit dhe banoret ne zonen e projektit ku do kryhet nderhyrjet.

Zona e projektit është e vendosur në afërsi të rrugës kryesore (rruga “Perlat Rexhepi”) me trafik të lartë dhe ne kete menyre *intensiteti i ndikimit* do të jetë *I ulët*. Kjo edhe në vijim të natyrës me ndërprerje dhe kohe –zgjatjes te shkurtër të aktiviteteve. Megjithatë, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë *E lartë* pasi mund të ketë banorë asthmatik, si dhe prania e klientëve në bizneset Brenda zones së propozuar per nderhyrje, duke rezultuar në rëndësi të *moderuar* të ndikimit ne mjedis.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Aktivitetet e ndërtimit do të kryhen gjatë ditës.
- Do të mbahet nen kontroll shpejtësia e udhëtimet te automjeteve të ndërtimit në veçanti nëpër qendrën e qytetit;
- Kamionet do te mbulohen gjatë transportimit të materialeve të ndërtimit;
- Kurdo që është e nevojshme, zonat me pluhur dhe ato gjeneruese te pluhurit do te sperkaten apo lagen me ujë;
- Pajisjet e ndërtimit do të mbahen në gjendje të mirë operative për të reduktuar emetimet e gazrave;
- Ndërhyrjet restauruese dhe rikonstruktuese të objekteve te zones duhet të realizohen nga një kontraktor me përvojë dhe me një ndjenjë të verifikueshme ndërgjegjësimiti dhe përgjegjësie mjedisore.

- Punëtorët do të pajisen me Paisje Mbrojtëse Personale dhe do të zbatohet përdorimi i tyre.
- Zona e projektit do të jetë e rrethuar për të minimizuar migrimin e pluhurit nga era për në objektet e afërta.

Përkeqësim i përkohshëm i pamjes vizuale

Aktivitetet e ndërtimit do të kërkojnë vendosjen e materialeve, pajisjeve dhe rrethimin e plote ose të pjesshem të zones. Duke qene se ansambli historik dhe objektet e tjera do të mbeten të hapura për qasje nga publiku, prezenca e këtyre aktiviteteve dhe materialeve do të shkaktojë përkeqësim të përkohshëm të pamjes vizuale në vendin e ndërtimit. Prania e aktiviteteve të ndërtimit do të ndryshojë përshtypjet vizuale me të cilin jemi mësuar.

Kohëzgjatja e ndikimit vizual do të jetë *afatshkurtër* pasi zgjat vetëm gjatë fazës së restaurimit/ rikonstruksionit/ riunifikimit. Intensiteti i ndikimit do të jetë *shumë i ulët* duke pasur parasysh gjendjen e rrënuar të shumices së objekteve ekzistuese. Prandaj, ndjeshmëria mbi receptorët do të jetë e ulët, kështu që rëndësia e ndikimit do të jetë *E vogël*.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatare	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

Kontraktori do të sigurojë që gjurmët e aktiviteteve të ndërtimit të jenë në nivele minimale.

Siguria dhe shëndeti në punë (OHS): Rreziku për kontraktoret.

Aktivitetet e ndërtimit mund të paraqesin rreziqe potenciale disa prej të cilave mund të jenë të rrezikshme për jetën, për shembull, renia nga lartësia mund të jetë fatale nëse punëtorët nuk përdorin rripat e sigurisë kur punojnë në lartësi. Puna me tension të lartë apo puna me nxehtësi (sikurse saldimi), përbëjnë një rrezik për demtime nga elektriciteti. Përveç kësaj, renia e mbetjeve nga lartësia mund të plagosë punëtorët që janë poshtë në qoftë nuk përdoren pajisjet

personale mbrojtëse (PPM). Lëndime ose demtime te shtylles kurrizore mund të ndodhin në qoftë se punëtorët mbajnë objekte të rënda. Rreziqe të tjera të mundshme mund të jenë: ndriçimi joadekuat gjatë orëve te nates ose nivel të kufizuar të shikimit gjatë fortunave duke krijuar vështirësi për stafin e makinerive te pajisjeve të rënda, makinave me sistem te papershtatshem frenimi, mungese përqendrimi ndersa punohet dhe ekspozimi ndaj mbetjeve të rrezikshme të tilla si bojrat, çimento, adhezive dhe tretësit per pastrim. Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë *afatshkurtër* pasi mund te ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërtimit. Shtrirja e ndikimit do të jenë *lokale ose kombëtare* në varësi të origjinës te punëtorëve.

Legjislacioni Shqiptar kërkon që punëtorët e ekspozuar ndaj niveleve të zhurmës më të larta se 80 dB (A) për një kohëzgjatje prej më shumë se 8 orë në ditë duhet te perdorin pajisje mbrojtëse per organet e degjimit.

Mundësia e ndodhjes se ketij ndikimi do të jetë *mesatare* duke pasur parasysh nivelin e sigurisë në sektorin e ndërtimit në Shqipëri. Intensiteti i ndikimit do të jete *mesatar* duke marre ne konsiderate faktin që disa aksidente mund të jetë te vogla dhe jo kërcënuese per jetën, ndërsa të tjerët mund të jenë të rënda duke çuar në paaftësi te përhershme ose humbjen e jetës së punëtorëve. Ndjeshmëria e receptorit është *mesatare* duke rezultuar në një rëndësi të moderuar të ndikimit.

Rëndësia e ndikimit:

			Ndjeshmeria e receptorit			
			Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare	E lartë 4
					3	
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët	1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël
	E ulët	2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar
	Mesatar e	3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh
	E lartë	4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Trajnimi i gjithë punëtorëve te ndërtimit lidhur me praktikatat dhe udhëzimet per sigurine ne punë dhe kontrolli i vazhdueshem që ata t'i përmbahen atyre.
- Trajnimi do të kryhet si për të parandaluar ashtu dhe për të menaxhuar incidentet. Kjo do të përfshijë trajtimin e duhur lidhur me menyren se si te reagojne kur ka probleme me energjine elektrike, ujin, etj. dhe sensibilizimin për mënyrat e ndryshme të sjelljes dhe

përgjegjësisë gjatë incidenteve të tilla. Të gjithë punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të përgatitur mendërisht për emergjencat të mundshme.

- Stervitjet e rregullta dhe stimulime të ndryshme duhet të zhvillohen vazhdimisht për incidente të ndryshme të mundshme. Kjo do të testojë reagimin e palëve të përfshira në stervitje të tilla dhe do ti mbajë ata vigjilent duke i bërë më të përgjegjshëm në rastin e incidenteve.
- Për të paralajmëruar stafin dhe / ose vizitorët që nuk janë të përfshirë në aktivitetet e ndërtimit lidhur me vendet e rrezikshme duhet të përdoren tabelat sinjalizuese (Figura 39).
- Për shoferët e pajisjeve të rënda duhet të jepen udhëzime strikte.
- Mbikëqyrja e punimeve duhet të bëhet rregullisht për të siguruar që janë plotësuar kushtet e sigurisë, ndërsa çdo devijim nga rregullat e sigurisë duhet të permisoher menjëherë duke ndjekur praktikën më të mirë në lidhje me sigurinë e pajisjeve të punës.



Figure1. Tabela sinjalizuese që mund të vendosen në kantiere

- Ndërmjet punëtorëve dhe shoferëve të pajisjeve të rënda duhet të sigurohet një komunikim shumë i mirë.
- Të zhvillohen procedurat e evakuimit për të trajtuar situatat emergjente.
- Punëtorëve të ndërtimit duhet tu sigurohen veshje të pershtashme mbrojtëse.

Aksidentet

Zona e projektit ndodhet në pjesë mjaft të populluar të Vlorës ku zhvillohen një sërë aktivitetesh tregëtare. Me rritjen e numrit të automjeteve gjatë transportimit të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, mund të ketë rritje të rrezikut të aksidenteve apo lëndimeve të lidhura me trafikun. Aksidentet e trafikut do të jenë një ndikim i rëndësishëm social dhe veçanërisht ka të ngjarë të përfshijnë fëmijë, gra (të cilët zakonisht i kryqezojnë rruget me ngadale se meshkujt), njerëzit me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, pa harruar rreziqet që mund të vijnë nga rena poshte e materialeve apo mbeturinave nga aktivitetet e ndërtimit.

Rena e rrethimit apo skelave mund të shkaktojnë aksidente të dëmshme për jetën e njeriut.

Persa i perket kohëzgjatjes ky ndikim do të jetë *afatshkurtër* dhe do ndodhi vetëm gjatë fazës së ndërhyrjeve. Shtrirja e ndikimit do të jenë lokale ose rajonale në varësi të origjinës së punëtorëve. Gjasat që ndikimi të ndodhi janë *mesatare* duke patur parasysh nivelin e ulët të sigurisë rrugore nga shoferët dhe këmbësorët në Shqipëri. Ndjeshmëria e receptorëve është *E lartë* pasi disa aksidente mund të çojnë në dëmtime të përhershme dhe të tjerë në humbje të jetës, ndërsa intensiteti i ndikimit është *i ulët* duke pasur parasysh vëllimin relativisht të lartë të trafikut që ndodh në zone. Prandaj rëndësia e ndikimit është *e moderuar*.

Rëndësia e ndikimit:

		Ndjeshmeria e receptorit				
		Shumë e ulët 1	E ulët 2	Mesatare 3	E lartë 4	
Intensiteti i ndikimit	Shumë e ulët 1	1 i papërfillshëm	2 i vogël	3 i vogël	4 i vogël	
	E ulët 2	2 i vogël	4 i vogël	6 i moderuar	8 i moderuar	
	Mesatare 3	3 i vogël	6 i moderuar	9 i moderuar	12 i madh	
	E lartë 4	4 i vogël	8 i moderuar	12 i madh	16 i madh	

Strategjitë për zbutjen e efekteve negative:

- Kontraktori do të miratojë praktikën më të mirë të sigurisë të transportit me qëllim të parandalimit të aksidenteve në trafik dhe minimizimin e lëndimeve të pësuar nga personeli i projektit dhe publiku, si më poshtë:
- Kontraktori do të vëre theksin tek siguria midis të gjithë shoferëve. Në mënyrë të veçantë kontraktori do duhet të sigurohet që shoferët të respektojnë kufijtë e shpejtësisë nëpër zonat me institucione publike;
- Tabelat sinjalizuese lidhur me trafikun do të jetë të pozicionuara në kryqëzimet e rrugëve për të kontrolluar shpejtësinë e levizjes së makinave;
- Do të merren masa për kontrollin e trafikut përfshirë përdorimin e shenjave në rrugë dhe personat me flamur që paralajmërojnë KUSHTET E RREZIKSHME dhe KALIMIN I FËMIJËVE.
- Projekti do të kërkojë që kontraktorët të kontrollojnë rregullisht automjetet për të minimizuar aksidentet potencialisht të rënda të tilla si ato të shkaktuara nga mosfrenimi në kohën e duhur që zakonisht ndodh me kamionët e mbingarkuar.

- Zona e projektit duhet të rrethohet dhe personeli i sigurisë duhet të ndalojë njerëzit e paautorizuar që të futen në objekt.
- Për mbeturinat që mund të bien dhe rrethimi, gjatë gjithë perimetrit të objektit duhet të vendosen shenja paralajmëruese, të vendosen rrjeta për të penguar që mbeturinat të bien dhe të theksohet përdorimi paisjeve mbrojtëse personale.
- Shenjat paralajmëruese duhet të tregojnë mundësinë që mund të bien mbeturina nga lart.
- Veshja e paisjeve mbrojtëse personale do të jetë kusht për punëtorët që janë në sheshin e ndërtimit.

Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi do të verifikojë nëse ndikimet e parashikuara kanë ndodhur në të vërtetë dhe kontrollojë nëse veprime zbutëse të rekomanduara në VNM janë zbatuar dhe cili ka qenë efektiviteti i tyre. Monitorimi do të identifikojë edhe ndikimet e paparashikuara që mund të lindin nga zbatimi i projektit.

Kush monitoron dhe si: Monitorimi do të kryhet nga Bashkia Vlore dhe Inspektorët e Mjedisit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) Vlorë që përfaqësojnë AKM. Monitorimi nga ARM-ja në këtë rast mund të konsiderohet si "Monitorim nga një palë e tretë", por ky është mandati i saj rregullator në përputhje me VKM Nr 47, datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit"

Një agjenci qeveritare që mund të ndërmarrë "Monitorimin nga një palë e tretë" është Inspektorati Shtetëror i Punës. Kjo njësi ka autoritetin për të inspektuar çdo strukturë për zbatimin e ligjshmërisë për sigurinë në vendet e punës.

Monitorimi do të bëhet me anë të inspektimit, shqyrtimit të ankesave të regjistruara nga palët e interesuara dhe diskutime ad hoc me persona potencialisht të prekur (punëtorët e ndërtimit, banorët pranë zones së projektit, etj.).

Auditimet: Auditimet do të jepen të nevojshme si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë funksionimit të projektit. Ndërsa auditimet e ndërtimit do të synojnë në verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat për masat zbutëse të ndikimit, auditimet post-ndërtimit janë një kërkesë ligjore dhe duhet të kryhen si rregull brenda 12 muajve.

Si auditimi gjatë ndërtimit ashtu edhe ai post-ndërtim mund të jepen të brendshëm (kryhen nga Bashkia e Vlores) ose të jashtëm (nga një konsulent i angazhuar nga Bashkia). Në këtë PMM është propozuar edhe buxheti përkatës, nëse auditimi do të kryhet nga një konsulent i punësuar për këtë qëllim.

Bashkia duhet të hartojë çdo muaj raporte mbi monitorimin. Këto raporte duhet ndahen me palët e interesuara. Bashkia mund të ndajë raportet e saj të auditimit gjatë fazës së ndërtimit dhe post-ndërtimit me AKM apo aktorë të tjerë të interesuar por nuk ka asnjë detyrim të bëjë të ditur auditimet në fazën e ndërtimit.

X. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

XI. PËRFUNDIME

- Projekti i propozuar ka potencialin për të përmirësuar ndjeshëm vlerat arkitektonike dhe historike të zonës, subjekt i projektit; rikthimin e vëmendjes tregtare me qëllim rritjen ekonomike të zonës dhe orientimi i turizmit në qytet jo vetëm drejt atij natyror por edhe turizmit kulturor, ku turistëve ti ofrohen site arkeologjike.
- Zhvillimi i projektit do të ofrojë mundësi të konsiderueshme ekonomike për furnizuesit e materiale/ pajisjeve, kontraktorët (kompanitë) e ndërtimit dhe profesionistët e zonës.
- Ndikimet kryesore të rëndësishme negative do të dalin nga trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta, rritjes së nivelit të pluhurit dhe zhurmave, si edhe transporti. Gjatë fazës së funksionimit, ndikimet do të jenë kryesisht pozitive si rritja e vlerës së pronës në zonë, rritja e numrit të bizneseve që operojnë në zonë, rritja e eficientes energjitike të ndërtesave, etj. Ndikimet negative kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve familjare, degradimin e ndërtesave në rast mos-mirembajtjeje dhe rrezikun e shpërthimit të zjarrit.

Pergatiti:

“Archispace” Shpk & “Gjeokonsult&Co”Shpk

Ing. Ferdinand KURTESHI